



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr.428/5 prot.

Tiranë, 31.10.2018

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 58, datë 1.8.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Besnik Muçi
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 17.10.2018, është njoftuar vendimi nr. 58, datë 1.8.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Besnik Muçi, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 58, datë 1.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## **I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, ushtron detyrën e Prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë dhe, duke qenë kandidat për anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë,<sup>1</sup> i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* me përparësi në kohë, bazuar në pikën 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

2. Mbështetur në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin z. Besnik Muçi ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme, nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Besnik Muçi*”<sup>2</sup>, ka referuar për subjektin, se:

- i. Ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit<sup>3</sup>, i ka referuar Komisionit: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*”.

2.3 Grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për aftësitë profesionale<sup>4</sup>, nga analiza e të cilit, së bashku me vlerësimin e denoncimeve nga publiku (3 të tilla), Komisioni nuk ka gjetur elemente që mund të ngrenë dyshime për aftësinë profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit.

---

<sup>1</sup> Referuar nenit 279, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

<sup>2</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2017.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2017.

<sup>4</sup> Përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2017.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e gjendjes pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të interesave pasurorë krahasuar me atë “Vetting”, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, të ardhurat, shpenzimet dhe pagimin e detyrimeve financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Nga kontrolli financiar-ligjor për 6 pasuri të paluajtshme, një autoveturë, të ardhurat, shpenzimet dhe likuiditetet, Komisioni ka arritur në përfundimin se: *“...Subjekti ka pasaktësi të vogla në plotësimin e deklaratave të pasurisë ndër vite, ka burime financiare të ligjshme, balancat financiare negative ndër vite janë të papërfillshme në lidhje me intensitetin e të ardhurave dhe të shpenzimeve të kryera, nuk ka kryer fshehje pasurie, nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.* Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

3.2 **Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka konstatuar se nuk është gjetur asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit, duke konkluduar se subjekti ka arritur nivel të besueshëm dhe është në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës si Prokuror.

3.3 **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44, të ligjit nr. 84/2016 dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016 , “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme<sup>5</sup>, hetimit dhe vlerësimit të 3 denoncimeve nga publiku dhe vlerësimin “i aftë” nga ana e relatorit të çështjes, ka arritur në konkluzionin se nuk është gjetur asnjë indicie apo element që mund të ngrejë dyshime për aftësinë profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit. Sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, referuar nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>5</sup> Bazuar në formularin e vetëdeklarimit, 3 dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe 5 dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor. Të dhëna nga burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

3.4 Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, Komisioni, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Muçi, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

## **II. Shkaqet e ankimit**

4. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

5. Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

6. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, pa pasur mundësinë ai vetë, Komisioneri Publik, që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave.

7. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

8. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, nga shqyrtimi i vendimit nr. 58, datë 1.08.2018, dhe provat e administruara për këtë qëllim nga Komisioni, vlerëson se vendimi përmban shkaqe ligjore që motivojnë rishikimin nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pasi:

8.1 Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioneri Publik konstaton se, për sa i takon kriterit të pasurisë, referuar kërkesave të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, përfundimet e Komisionit nuk janë në pajtueshmëri me aktet dhe provat e administruara.

8.2 Në këtë drejtim, Komisioneri Publik mban në konsideratë se objekti i vlerësimit të pasurisë, bazuar në nenin D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre dhe i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të. Si pasojë e këtij detyrimi kushtetues e ligjor, subjektit të rivlerësimit i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi/bashkëpronësi, posedim ose në përdorim të tij apo të personave të lidhur me të.

8.3 Sa më sipër, Komisioneri Publik, ndryshe nga përfundimet e Komisionit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në aktet e administruara për këtë qëllim, vlerëson se subjekti nuk arrin të justifikojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, si dhe gjendet në kushtet e mosdeklarimit të tyre, në kuptim kjo të nenit D, pika 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

8.4 Në këto kushte, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 58, datë 1.8.2018, të Komisionit ushtrohet për kriterin e vlerësimit të pasurisë të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

## **II. A Vlerësimi i pasurisë**

9. Vlerësimin e pasurisë, si një ndër tri kriteret e procesit të rivlerësimit kalimtar, e gjejmë të rregulluar në nenin D, të aneksit të Kushtetutës dhe kreun IV të ligjit nr. 84/2016, ku realizimin e qëllimit të nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës, këto norma e konkretizojnë në identifikimin e dy kategorive: (i) subjektet që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht (neni D, pika 1-3 dhe, sipas rastit, pika 4) ose (ii) ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur me ta (neni D, pikat 1 dhe 5).

10. Nën dritën e këtij qëllimi kushtetues, nëse nga vlerësimi tërësor i provave gjatë procesit të rivlerësimit identifikohen apo jo këto dy kategori, në përfundim organi rivlerësues, sipas rastit, për qëllim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, aplikon (i) nenin 59/1, të ligjit nr. 84/2016, kur provohet se nuk ka shkaqe ligjore për shkarkim, pra subjekti provon se plotëson së bashku kushtet për besueshmëri në vlerësimin e pasurisë, figurës dhe aftësitë profesionale, apo (ii) nenin 61, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016, kur rezulton se subjekti ka deklaruar më shumë se dyfishin e pasurisë së ligjshme apo rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë.

**11.** Në vështrim të sa më sipër, Komisioneri Publik çmon se konkluzioni përfundimtar i Komisionit se “... subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë...”, duke aplikuar kështu nenin 59/1, të ligjit nr. 84/2016, nuk i përgjigjet provave të administruara për këtë qëllim. Referuar gjendjes së këtyre akteve, vlerësojmë se subjekti nuk ka arritur të argumentojë dhe provojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, duke mos plotësuar kështu kërkesat e nenit D, të aneksit të Kushtetutës. Në arritjen e këtij vlerësimi, ashtu sikurse dhe shkaqet e këtij ankimi në vijim, bazohen pikërisht në kërkesat e kësaj dispozite kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, në elementet si: **(i)** saktësia dhe mjaftueshmëria e deklaramit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të dhe **(ii)** shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm i pasurive dhe të ardhurave.

**12.** Rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, është emëruar me detyrë Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Tiranë prej vitit 2002 dhe, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ka deklaruar pasuritë e tij dhe interesat privatë pranë ILDKPKI-së në vitin 2004 (numër indeksi \*\*\*). Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave privatë nga viti 2004 (dorëzuar për herë të parë në datë \*\*\*.3.2004) deri në vitin 2016 dhe, në zbatim të shtojcës 2, të ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar Vetting” më datë \*\*\*.1.2017 (referuar në vijim si deklarata “Vetting”).

**13.** Nga krahasimi i deklaratave periodike të pasurisë me deklaratën “Vetting” 2017, referuar nenit 32/5, të ligjit nr. 84/2016, për qëllim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, pra kontrolli i saktësisë, mjaftueshmërisë së deklaramit dhe burimi i ligjshëm i pasurive, ndër të tjera rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuri në pronësi dhe bashkëpronësi, për të cilat Komisioneri Publik, ndryshe nga Komisioni, çmon se subjekti nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të tyre, si dhe ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, referuar nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si vijon:

**A.1** Subjekti në deklaratën “Vetting” ka deklaruar **apartament me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup>**, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me adresë: rruga “\*\*\*\* \*\*\*\*”, \*\*\*, pa deklaruar pjesën takuese në pronësi. Deklaramin fillestar për këtë pasuri, subjekti e ka bërë në deklaramin e interesave privatë periodikë/vjetorë të vitit 2006.

**14.** Origjina e kësaj prone rrjedh nga kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë \*\*\*.1.2006, me vlerë 1.900.000 lekë, konfirmuar nga korrespondenca me ZVRPP-në \*\*\*.

14.1 Gjatë hetimit administrativ, kjo pasuri e paluajtshme rezulton të jetë deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë të vitit 2006, për një vlerë prej 1.900.000 lekë.

14.2 Në këtë deklaratë, në lidhje me burimin e të ardhurave për pagesën e vlerës së mësipërme, subjekti ka deklaruar tre zëra të ardhurash:

- a. hua nga babai, z. \*\*\*.\*\*\*., në vlerën 500.000 lekë;
- b. hua nga xhaxhai, \*\*\*.\*\*\*., në vlerën 3.000 euro; dhe
- c. hua nga motra, \*\*\*.\*\*\*., dhe bashkëshorti i saj, \*\*\*.\*\*\*., në vlerën 6.000 euro.

14.3 Ndërkohë, në deklaratën “Vetting”, të dorëzuar në datë \*\*\*.1.2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi si burim krijimi edhe kursimet e tij:

- (i) Kursime personale në shumën 200.000 lekë;
- (ii) hua 500.000 lekë nga babai, që vijnë nga të ardhura personale dhe kursime të vëllait, \*\*\*.\*\*\*., nga emigracioni;
- (iii) hua 6.000 euro nga motra \*\*\*.\*\*\*. dhe bashkëshorti i saj \*\*\*.\*\*\*., që vijnë si të ardhura nga emigracioni në \*\*\*;
- (iv) hua 3.000 euro nga xhaxhai, \*\*\*.\*\*\*., krijuar me të ardhura nga emigracioni.

### **i) Kursime**

**15.** Në verifikim të këtyre deklarimeve në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie të paluajtshme, rezulton se në datë \*\*\*.3.2006, nëpërmjet dorëzimit të deklaratës periodike vjetore të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, ka deklaruar interesat e tij privatë bazuar në ligjin nr. 9049/2003.

15.1 Në këtë akt, të administruar si provë nga ana e Komisionit, në kuptim të nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë se zotëron si kursime një shumë prej 200.000 lekësh, të mbajtura *cash* në shtëpi. Gjithashtu ka deklaruar të ardhura nga paga e tij për vitin 2005, të cilat rezultojnë në shumën 787.398<sup>6</sup> lekë, si dhe shpenzime qiraje në shumën 200.000 lekë. Nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit 2005, pasi zbriten shpenzimet e deklaruara, si dhe kursimi, rezulton se diferenca e mbetur nga të ardhurat, prej rreth 387.000 lekësh, nuk rezulton e mjaftueshme për të mbuluar konsumin minimal vjetor të një familjeje prej katër anëtarësh<sup>7</sup>.

<sup>6</sup> Vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, datë \*\*\*.10.2016.

<sup>7</sup> Referuar të dhënave zyrtare të INSTAT-it që aplikohen edhe nga ILDKPKI-ja për konsumimin vjetor.

15.2 Gjatë hetimit administrativ, nga analiza financiare për vitin 2005, subjekti ka rezultuar me një balancë financiare negative në vlerën -199.945 lekë. Lidhur me këtë fakt, Komisioni ia ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Muçi.

15.3 Në shpjegimet e tij drejtuar Komisionit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.7.2018, subjekti sqaron: *“Gjatë këtyre viteve, unë dhe familja ime kemi ndjekur një regjim të rreptë kursimi. Fëmijët kanë qenë të vegjël dhe kemi kryer vetëm shpenzime të nevojshme për jetesë (nuk kemi kryer udhëtime, pushime, kemi përdorur shërbimet publike për transport, nuk kemi udhëtuar asnjëherë jashtë Republikës së Shqipërisë, konfirmuar nga sistemi TIMS etj).*

*...gjatë kësaj periudhe, ne si familje jemi ndihmuar me shuma monetare dhe në forma të ndryshme, kemi marrë produktet bujqësore e blegtorale nga fshati etj., nga prindërit e mi, vëllai im \*\*\*. \*\*\*, i cili ka qenë emigrant në \*\*\*, dhe familja e vjehrrit \*\*\*. \*\*\*, i cili ka qenë i punësuar, dhe vjehrra ka pasur një biznes të vogël tregtimi të rrobave për fëmijë”.*

15.4 Pasi ka administruar përgjigjet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këto çështje për të cilat i ishte kaluar barra e provës, Komisioni ka arritur në përfundimin se: *“Në lidhje me balancën financiare negative, duke marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna nga subjekti për ndjekjen e një regjimi të rreptë financiar, si dhe ndihmat materiale të dhëna gjatë kësaj periudhe nga vjehri dhe vëllai i tij, konfirmuar me deklaratimet përkatëse, ajo rezulton të jetë e papërfillshme dhe nuk mund të arrihet në konkluzionin që kemi të bëjmë me shkelje ligjore, që mund të çojnë deri në shkarkimin e subjektit nga detyra”.*

15.5 Ky përfundim i Komisionit rezulton të mbështetet në një analizë financiare që i është bërë të ardhurave të subjektit të rivlerësimit, gjatë procesit të rivlerësimit, kryesisht duke u bazuar në pretendimet e paraqitura nga vetë subjekti, që mbeten thjesht në nivel deklarativ, të paprovuara.

15.6 Nisur nga përfundimi që arrin Komisioni për ligjshmërinë e të ardhurave në krijimin e shumës së kursimeve në vlerën prej 200.000 lekësh deri në vitin 2006, Komisioneri Publik vlerëson se, edhe pse analiza financiare e bërë nga Komisioni rezulton me balancë negative, përfundimi i Komisionit është i gabuar, pasi nuk mbështetet në dokumentet provuese që vërtetojnë deklaratimet e subjektit për sa i përket *“regjimit të rreptë ushqimor”*, detyrim ky i parashikuar në nenin 32, të ligjit 84/2016.

15.7 Në përfundim të hetimit, Komisioni justifikon ligjshmërinë e shumës së kursimit nga subjekti në vlerën 200.000 lekë, edhe pse nga analiza financiare për vitin 2005, e bërë nga vetë Komisioni rezulton me një balancë negative.



## **ii) Hua nga babai i subjektit z. \*\*\*. \*\*\*.**

**16.** Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka marrë hua nga z. \*\*\*. \*\*\*, për blerjen e apartamentit në rr. “\*\*\* \*\*”, ashtu si dhe në deklaratën e interesave private periodikë/vjetorë për vitin 2006, si një nga zërat e të ardhurave të deklaruara për blerjen e sendit, është huaja e marrë prej këtij personi tjetër të lidhur, në vlerën prej 500.000 lekësh. Sipas deklarimeve, të ardhurat e huas janë siguruar nga puna në bujqësi dhe puna në emigracion, \*\*\*. Kjo marrëdhënie huaje nuk është formalizuar me shkrim midis palëve.

16.1 Nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ të Komisionit, në lidhje me këtë fakt subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit aktet shkresore:

16.1.1 Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2018, nga Njësia Administrative \*\*\*, Bashkia \*\*\*, ku z. \*\*\*. \*\*\* ka në zotërim tokë bujqësore, duke realizuar nga kjo e fundit të ardhura vjetore në shumën 64.630 lekë.

16.1.2 Deklaratë pa datë, me shkrim dore të huadhënësit \*\*\*.\*\*\*., ku konfirmon huan e dhënë dhe si burim krijimi për këtë hua deklaroi kursimet personale dhe të ardhurat nga emigracioni i djalit tjetër, \*\*\*.\*\*\*.

16.1.3 Lidhur me të ardhurat nga emigracioni i të vëllait, \*\*\*.\*\*\*., subjekti ka paraqitur deklaratë pa datë, me shkrim dore, të vëllait, ku deklaroi se ka qenë emigrant dhe realizonte të ardhura mesatare mujore 1.500 - 2.000 euro/muaj.

16.1.4 Ka paraqitur gjithashtu disa dokumente të tjera të vëllait \*\*\*.\*\*\*., gjatë periudhës së emigracionit në \*\*\*, si kontratë qiraje të vitit 2001, kartën për leje qëndrimi \*\*\*, si dhe dokumente mbi pagesën e sigurimeve shoqërore dhe vërtetim për pajisje me kodin fiskal tatimpaguesi në datë \*\*\*.2.2001.

## **iii) Hua nga xhaxhai i subjektit z. \*\*\*.\*\*\*.**

**17.** Bazuar në pikën 4, të nenit 32, të ligjit 84/2016, Komisioni ka konsideruar xhaxhain e subjektit, \*\*\*.\*\*\*., si person tjetër të lidhur, pasi në deklarin e tij në deklaratën “Vetting”, deklaroi se për blerjen e apartamentit në rr. “\*\*\* \*\*” ka marrë hua nga z. \*\*\*. \*\*\*. në vlerën prej 3.000 eurosh. Sipas deklarimeve, të ardhurat e huas janë siguruar nga puna në bujqësi dhe kursime nga emigracioni në \*\*\*. Nga provat e administruara nuk rezultoi që kjo marrëdhënie huaje të jetë formalizuar me shkrim.

17.1 Për të provuar aftësinë huadhënëse të xhaxhait të tij, subjekti i ka paraqitur Komisionit si provë shkresore vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2018, nga Njësia Administrative \*\*\*,

Bashkia \*\*\*, ku rezulton se z. \*\*\*. \*\*\*. ka në zotërim tokë bujqësore dhe realizon prej saj të ardhura vjetore në shumën 111.465 lekë.

17.2 Përfundimi i Komisionit, për huatë në pikën ii) dhe iii), nuk ka dyshime në lidhje me aftësinë huadhënëse të babait të subjektit, \*\*\*. \*\*\*. dhe xhaxhait \*\*\*. \*\*\*, që kanë mundur huadhënien për subjektin e rivlerësimit në vlerat respektive, nuk është i bazuar në prova dhe në dispozitat e ligjit nr. 84/2016.

17.3 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të provuar aftësinë huadhënëse të babait dhe xhaxhait, Komisioni nuk ka hetuar mbi vlefshmërinë ligjore dhe provueshmërinë e tyre, por i ka marrë të mirëqena ato. Vlerësojmë se disa prej tyre nuk kanë asnjë vlerë provuese në formën e paraqitur, sepse janë vetëdeklarime dhe të tjera, dokumente pa vulë apostile, me përkthim të thjeshtë nga gjuha \*\*\*, pa u vërtetuar nënshkrimi i përkthyesit nga noteri publik. Pra, në kushtet kur një akt shkresor është mbajtur dhe lëshuar në territorin e një shteti tjetër si dhe në gjuhë të huaj, duhet të respektohen elementët formalë për vlefshmërinë e tij të përcaktuara në parashikimet e Konventës e Hagës datë 5 Tetor 1961, apo parashikimet e nenit 266 të KPr.Civile, i cili kërkon se “Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhë shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent.”

17.4. Gjithashtu, konkluzioni i Komisionit është i pabazuar, pasi ai nuk mbështetet në asnjë analizë financiare. Nga arsyetimi i vendimit nuk na rezulton që Komisioni të ketë hetuar dhe kryer analizë të detajuar, nëse familja e huadhënësit \*\*\*. \*\*\*. dhe \*\*\*. \*\*\*. ka realizuar apo jo të ardhura të tjera përveç sa konfirmuar nga Njësia Administrative \*\*\*, numrin e personave të përbërjes familjare, si dhe shpenzimeve të kryera nga i ati për ndërtimin e banesës së tij në tokën e fituar, me qëllim përlllogaritjen e mundësisë së tij për të dhënë këtë hua.

17.5. Të ardhurat e babait, \*\*\*. \*\*\*, sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2018, të dorëzuar nga subjekti, dhe të ardhurat e xhaxhait, \*\*\*. \*\*\*, sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2018, lëshuar të dyja nga Njësia Administrative \*\*\* do të konsiderohen të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit 84/2016. Në kuptimin që i jep ligjvënësi, Komisioni nuk ka administruar asnjë dokumentacion për shlyerjen e detyrimeve tatimore për shumën e deklaruar.

17.6 Komisioni, në referencë të standardit të vendosur prej tij në raste të ngjashme,<sup>8</sup> ka pasur korrespondencë dhe ka administruar në cilësinë e provës të dhëna nga organet tatimore

---

<sup>8</sup> Shih vendimin e KPK-së nr. \*\*\*, datë \*\*\*.3.2018.

përkatëse për vërtetimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave të pretenduara si burim krijimi pasurie nga subjektet e rivlerësimit, duhet të kishte shteruar hetimin në këtë drejtim dhe pas administrimit të dokumentacionit tatimor të kualifikonte si të ligjshme të dyja huatë e deklaruar si zë të ardhurash për krijimin e pasurisë.

**iv) Hua nga personi tjetër i lidhur, motra \*\*\*, \*\*\*, dhe bashkëshorti i saj, \*\*\*, \*\*\*.**

18. Subjekti, në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë, të dorëzuar për vitin 2006, dhe në atë “Vetting”, si një nga zërat e të ardhurave të deklaruar për blerjen e sendit është dhe huaja e marrë prej këtij personi tjetër të lidhur, në vlerën prej 6.000 eurosh. Huaja nuk është formalizuar në një akt të shkruar.

18.1 Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e provës për ekzistencën e aftësisë financiare të personit tjetër të lidhur për të dhënë hua, ka paraqitur dokumentet:

18.1.1 Deklaratë me shkrim dore të motrës dhe kunatit, pa datë, në të cilën deklarojnë se në vitet 1997 - 2009 kanë qenë emigrantë në \*\*\*, si dhe kanë deklaruar punëdhënësit (kunati) për këtë periudhë.

18.1.2 Nxjerrje të llogarisë bankare nga \*\*\* në emër të motrës dhe kunatit.

18.1.3 Numrat e sigurimit të motrës dhe kunatit në shtetin \*\*\*.

18.1.4 Nxjerrje llogari bankare nga banka në \*\*\*, ku vërtetohen disa kreditime/pagesa në favor të kunatit \*\*\*, \*\*\*, të shkëputura në kohë<sup>9</sup>.

18.1.5 Korrespondencën *online* të znj. \*\*\*, \*\*\*. me Bankën \*\*\* në \*\*\*, ku rezulton se janë kërkuar informacione mbi llogaritë bankare.

18.2. Përfundimi i Komisionit për këtë hua nuk ka dyshime në lidhje me aftësinë huadhënëse që ka mundësuar huadhënien nga \*\*\*, \*\*\*. dhe \*\*\*, \*\*\*. për subjektin e rivlerësimit, në vlerën 6.000 euro, nuk është i bazuar në gjendjen faktike të provave dhe në dispozitat e ligjit nr. 84/2016.

18.3. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, huaja nuk mund të konsiderohet si burimi i ligjshëm për krijimin e kësaj pasurie për argumentet si vijojnë:

18.4 Për sa i përket dokumentacionit justifikues, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të provuar aftësinë huadhënëse të motrës \*\*\*, \*\*\*. dhe kunatit \*\*\*, \*\*\*, Komisioni nuk ka hetuar mbi vlefshmërinë ligjore dhe provueshmërinë e tyre, por i ka marrë të mirëqena ato. Vlerësojmë

---

<sup>9</sup> Janar 2009, paguar në llogarinë bankare, shuma 4.888,38 paund, dhjetor 2008, paguar shuma 1.282,97 paund, shkurt 2007, paguar shuma 1.581,48 paund, dhjetor 2006, paguar shuma 1.507,69 paund, korrik 2006, paguar shuma 1.398,72 paund, shkurt 2006, paguar shuma 1.182,87 paund.

se gjithë provat e paraqitura faktojnë deklarin e personave të lidhur mbi jetesën dhe mundësinë e punësimit në \*\*\*, por asnjë prej tyre nuk provon të ardhurat e realizuara nga punësimi. Dokumentet e mësipërme janë fotokopje të thjeshta, disa vetëm në gjuhën \*\*. Nga ana formale, këto dokumente nuk kanë fuqi provuese, sepse janë kopje, pa vulë apostile, disa pa përkthim dhe të tjerat me përkthim të thjeshtë, i mungon vërtetimi i nënshkrimit të përkthimit nga noteri publik.

18.5 Komisioni e ka konsideruar motrën \*\*\*, \*\*\*, dhe kunatin e subjektit, \*\*\*, \*\*\*, person tjetër të lidhur<sup>10</sup>, dhe, mbështetur në nenin 49, të ligjit 84/2018, ka administruar dokumentacionin bankar për llogaritë e tyre.

18.6 Komisioni, edhe pse ka administruar me cilësinë e provës dokumentacionin bankar të personit të lidhur, nuk ka verifikuar përmbajtjen e tyre. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare të znj. \*\*\*,\*\*\*, në \*\*\*, rezulton se vetë subjekti në dy raste ka derdhur shuma në llogarinë në euro të motrës \*\*\*, \*\*\*, në \*\*. Konkretisht, në vitet 2005 - 2006 janë kryer disa derdhje në llogari, me përshkrimin: pagesë për studime, nga të cilat, në korrik 2006, depozituar 5.000 euro nga Besnik Muçi, në shtator 2006, depozituar 6.000 euro nga Besnik Muçi dhe në tetor 2007, tërhequr 5.000 euro nga Besnik Muçi, me prokurë. Shumat e derdhura për studime duket që janë transferuar/tërhequr me pjesë.

18.7 Komisioni nuk ka pyetur subjektin për shumat me të cilat ka kredituar llogaritë e motrës së tij, ndërkohë që kjo e fundit i ka dhënë huan në shumën 6.000 euro, fakt i cili në optikën e Komisionerit Publik do të duhej të hetohej në mënyrë shteruese.

18.8 Në çdo rast, aktet e administruara në dosje nuk provojnë mundësinë huadhënëse të personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*, \*\*\*, dhe z. \*\*\*,\*\*\*, në vitin 2006. Gjithashtu, konkluzioni i Komisionit është i pabazuar, pasi ai nuk mbështetet në asnjë analizë financiare. Komisioni për sa ka arsyetuar në vendim, nuk na rezulton që të ketë kryer analizë financiare dhe të ketë hetuar nëse familja e huadhënësit \*\*\*, \*\*\*, dhe \*\*\*,\*\*\*, ka realizuar apo jo të ardhura të ligjshme, numrin e personave të përbërjes familjare, si dhe shpenzime të kryera nga ata për jetesë apo dhe të tjera në periudhën e emigrimit, nëse kanë investuar në pasuri, me qëllim përlllogaritjen e mundësisë së tyre për të dhënë këtë hua.

18.9 Referuar përmbajtjes së akteve të administruara, nga ana e Komisionit nuk është administruar asnjë provë mbi ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur, znj. \*\*\*, \*\*\*, dhe z. \*\*\*, \*\*\*, që ka shërbyer si burim për dhënien e huas. Komisioni është mjaftuar

---

<sup>10</sup> Bazuar në pikën 14 nenit 3 dhe pikë 4 nenit 32 të ligjit 84/2016.

me faktin që gjendje në llogarinë bankare të znj. \*\*\*, \*\*\*, në \*\*\*, në datë \*\*\*.12.2005, ishte shuma 8.600 euro dhe nuk ka hetuar më tej në këtë drejtim.

18.10 Në përgjigjet e pyetësorit nr. \*\*\*, datë \*\*\*.6.2018, subjekti, njëkohësisht me dorëzimin e provave, ka shprehur gatishmërinë për paraqitjen e dokumentacionit shtesë nga motra dhe bashkëshorti i saj për justifikimin e të ardhurave për punën në emigracion, \*\*\*. Komisioni në vlerësimin e tij nuk e ka quajtur të nevojshme të thellonte hetimin me marrjen e provave të tjera në lidhje me burimin e krijimit të të ardhurave të personave huadhënës.

18.11 Në zbatim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, nenit 3, pika 4, 30 dhe nenit 32 pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni duhet të dilte në përfundimet përkatëse për ligjshmërinë e të ardhurave të personit tjetër të lidhur, vetëm pasi të krijonte bindjen se ato (të ardhurat) ekzistonin në momentin e dhënies së huas dhe se ekzistenca e tyre justifikohesh nga burime të ligjshme.

18.12 Në mënyrë të përmbledhur, sa analizuam më sipër mbi kursimet dhe huatë, nga analiza financiare e vitit 2006 mbi mbulimin e shpenzimeve të subjektit me të ardhurat e ligjshme në kuptim të pikës 1 dhe 3, të nenit D të aneksit të Kushtetutës, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.1 - Analizë financiare, viti 2006

<b>Viti 2006</b>	
Të ardhura nga pagat SR	811.967 <sup>11</sup> lekë
Të ardhura nga pagat e bashkëshortes	62.833 <sup>12</sup> lekë
<b>Total i të ardhurave familjare</b>	<b>874.800 lekë</b>
Shpenzime minimale jetese	600.000 lekë
Shpenzim për blerjen e apartamentit	1.900.000 lekë
Shlyer detyrime	500.000 <sup>13</sup> lekë
<b>Total i shpenzimeve</b>	<b>3.000.000 lekë</b>
Ndryshimi i likuiditeteve në llogaritë bankare	(106.048) lekë
<b>Diferenca për mbulimin e shpenzimeve</b>	<b>(2.019.152) lekë</b>

18.13 Ndryshe nga përfundimet e arritura nga Komisioni, të cilat janë pasqyruar në pjesën arsyetuese të vendimit nr. 58, datë 1.8.2018, në vlerësimin e Komisionerit Publik, në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave që janë deklaruar se kanë shërbyer për blerjen e pasurisë së paluajtshme “Apartament banimi me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup>, me adresë rr. “\*\*\* \*\*”, na

<sup>11</sup> Të ardhurat neto sipas vërtetimit nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, datë \*\*\*.10.2016.

<sup>12</sup> Të ardhurat neto sipas vërtetimit nga DAR, Tiranë, datë \*\*\*.10.2016.

<sup>13</sup> Shlyer huaja ndaj të atit sipas deklarimit në deklaratën vjetore të vitit 2006.

rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, në referencë të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

**A.2** Për pasurinë, apartament banimi me sip.78.4 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*.

**19.** Në deklaratën “Vetting”, subjekti deklaron: shtëpi banimi, apartament sip. 78.4 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, Rruga \*\*\*, \*\*\*. Blerë për shumën 75.000 euro, me kontratën nr.\*\*\* rep. dhe \*\*\* kol., datë \*\*\*.5.2016.

19.1 Burimi i krijimit të pasurisë: (i) Kursime nga të ardhurat prej punës së deklaruesit dhe bashkëshortes 25.000 euro; (ii) Hua në shumën 15.000 euro nga \*\*\* \*\*\* dhe \*\*\* \*\*\* (i vëllai i bashkëshortes së subjektit me bashkëshorten e tij, shtetase \*\*\*), burimi është nga kursimet e tyre prej punës në kompaninë “\*\*\*”, në pronësi të babait të \*\*\* \*\*\*, dhe menaxhimi i dy dyqaneve, shitje me shumicë dhe pakicë, mobilieri me sip. 2.000 m<sup>2</sup> dhe 3.600 m<sup>2</sup>, ndodhur në qytetin \*\*\*, \*\*\*. Shuma është transferuar nëpërmjet \*\*\*, në datën \*\*\*.5.2016; (iii) Kredi bankare pranë \*\*\*, Dega “\*\*\*”, në datën \*\*\*.12.2016, në shumën 1.500.000 lekë.

- Në Deklaratën për vitin 2016 (DV-2016), ku pasuria e mësipërme është deklaruar për herë të parë, deklarohen saktësisht të njëjta të dhëna si më sipër.

19.2 Nga aktet e administruara në dosje rezulton se, më datë \*\*\*.5.2016, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e blerësit, dhe shoqëria e ndërtimit “\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e shitësit, kanë lidhur një kontratë shitblerje me rezervë, me nr.\*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., para noterës publike \*\*\*. \*\*\*, me objekt apartament me sip.78.4 m<sup>2</sup>, për çmimin 75.000 euro. Referuar të drejtave dhe detyrimeve të blerësit, pagesa e plotë e çmimit të apartamentit do të kryhet në dy këste, ku kësti i parë, në shumën 40.000 euro, rezulton se është shlyer, konfirmuar nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit pranë \*\*\*. Subjekti ka depozituar shumën prej 10.000 euro në datë \*\*\*.7.2014 dhe 15.000 euro në datë \*\*\*.5.2016. Në datë \*\*\*.5.2016 rezulton e kredituar nëpërmjet transfertës bankare shuma prej 14.951,83 eurosh. Shuma e akumuluar prej 40.000 eurosh është transferuar në llogarinë bankare të noterës \*\*\*. \*\*\*, me përshkrimin “*tjetërsim pasurie sipas kontratës për blerje pasurie nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë \*\*\*.5.2016*”. Ndërsa, kësti i dytë, prej 35.000 eurosh, palët kontraktore kanë rënë dakord që të shlyhet nëpërmjet llogarisë bankare të noterit, deri në maj të vitit 2019. Nga korrespondenca e ndjekur e Komisionit me ZVRPP-në \*\*\* konfirmohet se në kjo pasuri është e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe, sipas kartelës së pasurisë së datës \*\*\*.6.2018, në seksionin “\*\*\*<sup>14</sup>”, rezulton

---

<sup>14</sup> Seksioni i hipotekave, vendimeve të Gjykatës, kufizimeve etj.

se kjo pasuri është e bllokuar në favor të shitësit deri në likuidimin e plotë të shumës, çmimit të shitjes.

**19.3 Komisioneri Publik**, nga analizimi tërësor i provave të administruara, bazuar në kërkesat e nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32/4, të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se edhe në këtë rast arsyetimi dhe konkluzionet e Komisionit në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie nuk gjejnë mbështetje ligjore. Referuar gjendjes së akteve dhe vlerës provuese të tyre rezultojnë se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk kanë arritur të justifikojnë bindshëm burimin e krijimit të pasurisë. Komisioni, në mënyrë të gabuar, ka mbajtur qëndrimin në lidhje me huan prej 15.000 eurosh nga personat e lidhur se: *“shuma është transferuar nëpërmjet \*\*\*... çka do të thotë se kemi të bëjmë me një transfertë nga banka në bankë, duke legjitimuar kështu burimin i të ardhurave që justifikon këtë gjendje financiare në bankën e origjinës prej nga është bërë transferta”* (f. 25 e vendimit).

19.4 Komisioneri Publik çmon se pasja ose jo e likuiditeteve në llogari bankare apo transferta bankare nuk janë fakte që legjitimojnë burimin e të ardhurave. Vlerësimi mbi legjitimitimin e burimit të pasurisë del si rezultat i hetimit administrativ të Komisionit dhe bëhet vetëm nëse plotësohen kushtet e nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32/4, të ligjit nr. 84/2016. Pra identifikohet dhe provohet burimi i ligjshëm dhe pagimi i detyrimeve tatimore. Në këto kushte, në vijim paraqesim vlerësimin tonë për secilin zë financiar, i cili është deklaruar nga subjekti si burim krijimi.

19.5 Mbi shumën prej 25.000 eurosh, deklaruar nga subjekti si kursim ndër vite. Referuar deklaratave periodike të pasurisë, subjekti, duke filluar nga viti 2009 – 2016, ka deklaruar si kursime vjetore shuma të cilat, nga analiza vjetore, rezultojnë se i mbulon me të ardhura të ligjshme. Këto kursime pjesërisht janë depozituar në sistemin bankar dhe pjesërisht janë deklaruar *cash*. Shuma e akumuluar është përdorur nga subjekti për shlyerjen e një pjese të detyrimit ndaj shoqërisë së ndërtimit, shitësit.

19.6 Mbi kredinë bankare. Subjekti ka deklaruar kredi bankare nga \*\*\*, konfirmuar nga kjo e fundit me anë të shkresës nr. \*\*\*, datë \*\*\*.6.2018, disbursuar në llogarinë bankare të më datë \*\*\*.12.2016 dhe e tërhequr *cash* nga subjekti. Subjekti ka vënë në dispozicion një mandat të Bankës \*\*\*, ku verifikohet derdhja e shumës prej 14.000 eurosh, datë \*\*\*.12.2016, në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrim veprimi: *derdh B. Muçi, shlyerje detyrimi për banesë, kredi te \*\*\* të ardhurat personale*, çka përputhet me deklarinimin e subjektit në deklaratën “Vetting” dhe në pyetësorët e Komisionit mbi përdorimin e kredisë së marrë, dhe një pjese të kursimeve personale për likuidimin e kështit prej 14.000 eurosh.

19.7 Mbi huan nga kunati rezulton se shuma prej 14.951,83 euro është transferuar në llogarinë bankare të subjektit pranë \*\*\*, në datë \*\*\*.5.2016. Mbi mundësinë e personave të lidhur për kursimin e shumës dhe ligjshmërisë së saj, rezulton se subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës dokumente nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Republika e \*\*\*, për shtetasit \*\*\* \*\*\*, dhe \*\*\* \*\*\*. Ky dokumentacion është i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar, dhe tregon se shtetasit e mësipërm kanë paguar sigurime shoqërore në përputhje me legjislacionin në fuqi për periudhat: viti 2006 (1 muaj); viti 2007 (2 muaj), si dhe për periudhën 2012 - 2017 për shtetasin \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*. Ndërsa për shtetasin \*\*\*, \*\*\*, rezulton se janë paguar sigurime shoqërore për periudhën 2012-2017.

19.8 Ndryshe nga përfundimi i Komisionit se: “duke marrë në konsideratë analizën e llogarive bankare, deklaratimet e subjektit... nuk ka dyshime në lidhje me ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave monetare<sup>15</sup>”, Komisioneri Publik çmon se aktet e administruara nuk të krijojnë bindjen se të ardhurat e deklaruara si hua justifikojnë burimin e ligjshëm të tyre, pasi dokumentacioni i paraqitur nga subjekti prej Institutit të Sigurimeve Shoqërore, \*\*\*, merret me rezervë për vlerën provuese të tyre. Në aspektin formal, ky dokumentacion nuk shoqërohet me vulën apostile, si dhe nuk vërtetohet se sa janë të ardhurat e realizuara nga personat e lidhur për periudhën 2012 - 2016. Edhe në këtë rast rezulton se Komisioni nuk ka hetuar apo të ketë kryer analizë financiare mbi të ardhurat e realizuara nga huadhënësit, kostot e jetesës së tyre dhe mundësinë e këtyre personave për të dhënë hua shumën prej 15.000 eurosh. Si rrjedhim, për sa kohë që subjekti dhe personat e lidhur nuk provojnë bindshëm ligjshmërinë e kësaj huaje, në kuptim të nenit D/3, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32/4, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në pamundësi financiare për mbulimin me të ardhura të ligjshme për blerjen e pasurisë së mësipërme (për pjesën e deklaruar të mbuluar nga huaja). Në mënyrë të përmbledhur, analiza financiare e vitit 2016 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 2

<b>Analizë financiare viti 2016</b>	
Të ardhura nga pagat SR	1.633.177,00 lekë
Të ardhura nga pagat Bsh	433.008,00 lekë
Të ardhura nga qiraja	120.000 <sup>16</sup> ,00 lekë
<b>Total i të ardhurave të subjektit (I)</b>	<b>2,186,185.00 lekë</b>
Hua bankare (II)	1.660.000 <sup>17</sup> ,00 lekë
Likuiditete <i>cash</i> dhe në llogarinë bankare, të përdorura për blerjen e apartamentit <sup>18</sup> (III)	3.682.463,95 lekë
<b>Total likuiditete në dispozicion (IV = I+II+III)</b>	<b>7.528.648,95 lekë</b>

<sup>15</sup> F. 27 e vendimit.

<sup>17</sup> Hua nga \*\*\* 1.500.000 lekë dhe overdraft 160.000 lekë.

<sup>18</sup> Sipas konfirmimeve të llogarive bankare në fillim dhe në fund të vitit 2016 dhe deklaratimeve të subjektit mbi përdorimin e kursimeve të akumuluar.



Shpenzime jetese	750.000,00 lekë
Shpenzime shkollimi	162.324,00 lekë
Shpenzim blerje apartamenti	7.302.420 <sup>19</sup> ,00 lekë
Shpenzime blerje automjeti	838.426,00 lekë
Shpenzime rinovim shtëpie	468.000,00 lekë
Shpenzime udhëtimi	37.876,00 lekë
<b>Total i shpenzimeve (V)</b>	<b>9.559.046,00 lekë</b>
<b>Diferenca për mbulimin e shpenzimeve (VI = IV-V)</b>	<b>(2.030.397,05) lekë</b>

## 20. Mosdeklarimi i pasurisë

20.1 Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, nga të dhënat e Regjistrimit Noterial Shqiptar pranë Ministrisë së Drejtësisë<sup>20</sup>, ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit së bashku me familjarët e saj (prindërit, e motra dhe vëllai), në cilësinë e bashkëpronares me pjesë të barabarta dhe e pandarë të pasurisë së paluajtshme, truell me sip.178 m<sup>2</sup> dhe sip. ndërtese 100 m<sup>2</sup>, ka nënshkruar një kontratë shitje më datë \*\*\*.1.2018, me nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., për kalimin e pronësisë së këtyre pasurive për çmimin 1.300.000 lekë, kundrejt blerësit \*\*\*. \*\*\*. Nisur nga ky fakt, Komisionit i ka rezultuar se këto pasuri nuk janë deklaruar ndonjëherë as në deklaratat periodike, ashtu dhe në atë Vetting, për rrjedhojë nga Komisioni është konsideruar si pamjaftueshmëri në deklaram.

20.2 Mbi arsyet e mosdeklarimit të këtyre pasurive, subjekti, ndër të tjera, ka pretenduar se prona e mësipërme është ndërtuar mbi truallin e dhënë nga shteti, rreth vitit 1985, nga babai i bashkëshortes, shtetasi \*\*\*. \*\*\*. Në vitin 1997, pasi jemi martuar, bashkëshortja ime është shkëputur nga familja e saj. Në momentin që prona është dashur të shitet, noteri publik, duke e konsideruar një pjesë të kësaj prone truallin mbi të cilin është ndërtuar shtëpia, si pronë e familjes bujqësore, pasi i është dhënë familjes nga shteti pa shpërblim para vitit 1991, për ta konsideruar të vlefshme shitjen, ka kërkuar nënshkrimin e të gjithë bashkëpronarëve. Pra, bashkëshortja është shkëputur nga familja prej 21 vitesh dhe nuk është konsideruar asnjëherë bashkëpronësia e kësaj prone, si dhe nuk janë përfituar asnjëherë fruta civile prej saj. Ndërkohë, në shpjegimet shtesë, gjatë seancës dëgjimore të datës \*\*\*.7.2018, subjekti ka sqaruar ndër të tjera se: *... mund të diskutohet bashkëpronësia vetëm mbi truallin, kjo për shkak se trualli është dhënë nga shteti për ndërtim rreth vitit 1985 (para vitit 1991, vetëm shteti ishte pronar i pasurive të paluajtshme). Ndërtesa është ndërtuar me kontributin e prindërve të bashkëshortes rreth vitit 1985 dhe, rrjedhimisht, këta të dy janë bashkëpronarë të saj.*

20.3 Komisioni, duke u bazuar në interpretimet e legjislacionit të kohës, si ligji nr. 7512, datë 10.8.1991, “Për mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura

<sup>19</sup> Kundërvlera e shumës së paguar gjatë vitit 2016, prej 54.000 eurosh.

<sup>20</sup> Referuar përgjigjes së ardhur nga Ministria e Drejtësisë me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2018.

dhe privatizimit” (i shfuqizuar), Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 14.8.1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit” (i shfuqizuar), rregullimit ligjor të tjetërsimit të sendeve të përbashkëta sipas Kodit Civil të vitit 1981, bashkëpronësinë midis anëtarëve të familjes bujqësore sipas nenit 222 të Kodit Civil në fuqi, ligjit nr. 8337, datë 30.4.1998, “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”, si dhe në interpretim të jurisprudencës në lidhje me familjen bujqësore, ka arritur në konkluzionin se: *“është më se e qartë se familja bujqësore është një grupim, përbërja e së cilës është në ndryshim të vazhdueshëm, ku hyjnë e dalin anëtarë për shkak të veprimeve të caktuara juridike (vajza martohet del nga familja bujqësore dhe nusja që vjen bëhet pjesë e familjes bujqësore, djali që shkëputet nga trangu familjar del nga familja bujqësore), si dhe për shkak të ligjit. Për rrjedhojë, personi i lidhur, me martesën e kryer me subjektin, ka humbur statusin e anëtares së familjes bujqësore të përfaqësuesit të saj... Sa më sipër, pronësia e shtëpisë së banimit (përfshirë edhe pronësinë mbi truallin) nuk gjen rregullim ligjor në ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”... Pavarësisht firmosjes nga ana e personit të lidhur me subjektin (bashkëshortja e tij) në kontratën e shitblerjes së shtëpisë së banimit, kemi të bëjmë me një interpretim të gabuar të ligjit nga noteri publik, duke e konsideruar shtëpinë e banimit në fshat... si një pasuri në pronësi të familjes bujqësore. Për rrjedhojë, si subjekti, ashtu dhe personi i lidhur me të, nuk kanë pasur detyrimin ligjor të deklarojnë këtë pasuri...”* (f. 29, 30 dhe 31 e vendimit).

20.4 Nga hetimi administrativ i Komisionit<sup>21</sup> ka rezultuar gjithashtu se në pronësi të babait të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e përfaqësuesit të familjes bujqësore, në z. k. nr.\*\*\*, \*\*\*, \*\*\* janë të regjistruara pasuritë e llojit:

- i. “Arë”, me sip. 1.092 m<sup>2</sup> dhe sip.1.071 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\*, \*\*\*.1996, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës \*\*\*.3.2008;
- ii. “Arë”, me sip. 1.120 m<sup>2</sup> dhe sip.1.120 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\*, \*\*\*.1996, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës \*\*\*.3.2008;
- iii. “Arë”, me sip. 2.177 m<sup>2</sup> dhe sip. 2.120 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\*, \*\*\*.1996, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës \*\*\*.3.2008;
- iv. “Arë”, me sip. 2.000 m<sup>2</sup> dhe sip.1.995 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\*, \*\*\*.1996, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës \*\*\*.3.2008;
- v. “Arë”, me sip. 2.250 m<sup>2</sup> dhe sip.1.600 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\*, \*\*\*.1996, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës \*\*\*.3.2008;
- vi. “Arë”, me sip. 600 m<sup>2</sup>, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës \*\*\*.3.2008.

<sup>21</sup> Referuar shkresës së ZVRPP-së \*\*\*, protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2018.

20.5 Nga korrespondenca me Bashkinë \*\*\*, Njësia Administrative \*\*\*, me anë të shkresës nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2018, konfirmohet se sipas certifikatës familjare të z. \*\*\* \*\*\* (babai i bashkëshortes së subjektit), në përbërjen e familjes bujqësore, më datë \*\*\*.8.1991, rezulton edhe personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit.

20.6 Në vijim të arsyetimit të mësipërm, Komisioni edhe në këtë rast ka konkluduar se *“pavarësisht se znj. \*\*\*. \*\*\* (personi i lidhur) ka qenë anëtare e familjes bujqësore... prej vitit 1997, kur ajo është shkëputur nga kjo familje për shkak të martesës... ajo nuk mund të përfitojë të drejta pronësore mbi pasuritë e kësaj familje bujqësore (përveç për shkaqe ligjore, si p.sh.: trashëgimia) e për rrjedhojë, si subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe znj. \*\*\*.\*\*\* nuk kanë pasur detyrim ligjor për deklarimin e kësaj pasurie në ILDKPKP”* (f. 33 e vendimit).

20.7 Referuar shkresës së ZVRPP-së \*\*\*, protokolluar pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2018, rezulton se edhe i ati i subjektit të rivlerësimit, z. \*\*\*. \*\*\*, në z. k. nr. \*\*\*, \*\*\*, \*\*\* ka të regjistruara pasuritë e llojit:

- i. “Truall”, me sip. 300 m<sup>2</sup> dhe ndërtim me sip. 160 m<sup>2</sup>, për të cilën nuk është bërë pajisja me certifikatë pronësie;
- ii. “Arë”, me sip. 455 m<sup>2</sup> dhe sip. 488 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\*, \*\*\*.1996, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës \*\*\*.9.2006, pa referencë në Arshivë;
- iii. “Arë”, me sip. 1550 m<sup>2</sup> dhe sip. 1524 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\*, \*\*\*.1996, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës \*\*\*.7.2003, pa referencë në Arshivë;
- iv. “Arë”, me sip. 831 m<sup>2</sup> dhe sip. 858 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\*, \*\*\*. 1996, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës \*\*\*.12.2002;
- v. “Arë”, me sip. 2.250 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\*, statusi “Familjare”, për të cilën nuk është bërë pajisja me certifikatë pronësie;
- vi. “Arë”, me sip. 3520 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\*, statusi “Familjare”, me datë lëshimi të certifikatës \*\*\*.8.2003.

20.8 Nga korrespondenca e Komisionit me Bashkinë \*\*\*, Njësia Administrative \*\*\*, konfirmohet se në certifikatën familjare të z. \*\*\* \*\*\* (babai i subjektit), më datë \*\*\*.8.1991, në përbërjen e familjes bujqësore rezulton edhe subjekti i rivlerësimit.

**20.9 Komisioneri Publik**, në shqyrtim të akteve të administruara, pretendimeve dhe provave të dorëzuara nga subjekti, vlerëson se arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga Komisioni se si shkak i martesës humbet të drejtat e bashkëpronësisë në tërësi nga familja bujqësore, është rrjedhojë e keqinterpretimit të ligjit civil. Nisur nga arsyetimi dhe përfundimet e Komisionit, duket sikur ky i fundit, bazuar në nenin 5/c, të ligjit nr. 8337/1998, “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”, ku përcaktohet se në çastin e kalimit të

pronësisë të tokës bujqësore kërkohen aktet që vërtetojnë përbërjen e familjes bujqësore, në mënyrë të gabuar, *ipso jure* ka zhveshur nga bashkëpronësia në tërësi e familjes bujqësore, sipas Kodit Civil, subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij, e rrjedhimisht, për qëllim të procesit të rivlerësimit ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e deklaramentit të pamjaftueshëm dhe mosdeklarimit të pasurisë, referuar nenit D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61/3, të ligjit nr. 84/2016.

20.10 Komisioneri Publik, bazuar në aktet e administruara, vlerëson se si subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të (bashkëshortja), sipas gjendjes familjare të datës \*\*\*.8.1991 kanë qenë pjesëtarë të familjeve bujqësore respektive dhe kanë përfituar tokë bujqësore sipas ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, regjistruar në ZVRPP-në \*\*\*, me statusin “familje bujqësore”. Bazuar në nenin 222<sup>22</sup> të Kodit Civil, ata tërheqin të drejta reale pronësore mbi pasuritë e mësipërme dhe sipas nenit 4, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar, ata kanë pasur detyrimin ligjor t’i deklaronin këto pasuri dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil<sup>23</sup>. Bashkëpronësia midis anëtarëve të familjes bujqësore paraqitet si bashkëpronësi në tërësi dhe për sa kohë nuk është bërë pjesëtimi sipas nenit 207 të Kodit Civil, ndaj saj zbatohen rregullat e përgjithshme dhe të posaçme të Kodit Civil për kryerjen e veprimeve juridike në tërësi apo dhe disponimit mbi to në veçanti.

20.11 Sipas ligjit nr. 7501/1991, ligjvënësi e njohu bashkëpronësinë mbi tokën bujqësore për të gjithë ata anëtarë të familjeve shqiptare që banonin dhe jetonin në fshat apo në ferma të ndryshme, por që ishin në përbërjen familjare të familjes bujqësore para daljes së këtij ligji, datë \*\*\*.7.1991. Pra, në këtë rast, vetëm ata persona që kishin lindur para datës \*\*\*.8.1991, kishin të drejtë të përfitonin nga dispozitat e ligjit, për t’u bërë bashkëpronarë të tokës bujqësore, e që do të përfitonin pas shpërbërjes së kooperativave dhe fermave bujqësore. Numri i anëtarëve të gjallë të familjeve bujqësore dhe rrjedhimisht numri i personave që do të ishin bashkëpronarë mbi tokën bujqësore, ishte një numër i përcaktuar me miratimin e ligjit “Për tokën” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 255, datë 2.8.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore<sup>24</sup>”. Në analizë literale të këtyre normave konstatojmë se natyra e bashkëpronësisë së familjes bujqësore në këtë rast, referuar edhe nenit 222 të Kodit Civil të vitit 1994, nuk mund të ndryshojë nën logjikën e pakësimit apo shtimit në mënyrë beneficiare,

---

<sup>22</sup> “Pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore përket në tërësi anëtarëve të saj, të cilët, nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara, kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e ekonomisë bujqësore”.

<sup>23</sup> Togfjalëshi “sipas Kodit Civil” është shtuar nga neni 4 i ligjit nr. 42/2017.

<sup>24</sup> Sipas pikës 2/1, 2 të këtij vendimi: “Në të gjitha rastet, toka ndahet përpjesëtimisht për çdo familje sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1 gusht 1991. Në numrin e frymëve të familjes bujqësore anëtare të kooperativës bujqësore do të llogariten gjithë frymët e saj, si: fëmijët, nxënësit, studentët, ushtarët, pensionistët, anëtarët e familjeve kooperativiste që punojnë me kontratë të përkohshme dhe refugjatët, pavarësisht nga seksi...”.

si shkak largimi apo ardhje të anëtarëve në familjen bujqësore nga martesë. Bashkëpronësia në tërësi e familjes bujqësore, për sa kohë nuk është pjesëtuar sipas rregullave të nenit 207 të Kodit Civil, secili prej tyre tërheq të drejta dhe detyrime ndaj asaj pasurie, qëndrim ky i konsoliduar edhe nga jurisprudenca e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë<sup>25</sup>.

20.12 Komisioneri Publik vlerëson se nuk ka asnjë rrethanë ligjore që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të të mos deklarojnë saktësisht dhe mjaftueshmërisht pasuritë e tyre në pronësi dhe bashkëpronësi. Neni D, pikat 1, 2 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, neni 32, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit 2017, detyron subjektin e rivlerësimit për deklarimin saktësisht dhe mjaftueshmërisht të “pasurisë” së tij dhe personave të lidhur, për “burimin” në momentin e krijimit të saj, ku me burim në këtë rast përfshihet si origjina, pra shkak apo veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, ashtu dhe mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj. Në këtë drejtim, deklarata e pasurisë “Vetting”, shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016, është mjaft e qartë kur përcakton se: Objekti i deklarimit: “Të gjitha pasuritë e akumuluar ndërr vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 e ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, **burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to**, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit **apo në bashkëpronësi** të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur. Përshkruani hollësisht: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, vitin e krijimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve shumë e shpenzimeve që keni kryer, pjesën takuese që zotëroni dhe burimet e krijimit të çdo lloji pasurie të regjistruar ose jo në regjistrat publikë”.

20.13 Bazuar në sa më sipër trajtuar, provohet se subjekti i rivlerësimit së bashku me personin e lidhur (bashkëshortja) ndodhen në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshmërisht për kriterin e pasurisë, në kundërshtim kjo me përcaktimet e nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Aplikimi i nenit 61/3, të ligjit nr. 84/2016, gjen zbatim si pasojë e kësaj gjendje fakti, konstatuar gjatë hetimit administrativ për qëllim të procesit të rivlerësimit. Në këtë drejtim mbajmë në konsideratë edhe pikën 75 të vendimit nr. \*\*\*, datë \*\*\*.9.2018, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ku ndër të tjera shprehet se: *“Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për procesin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë, në asnjë rast nuk e lidhin pamjaftueshmërinë e deklarimit me elementet subjektive të dashjes apo qëllimit”*. Në këtë

<sup>25</sup> Referohu vendimit nr \*\*\* i vendimit (\*\*\*), datë \*\*\*.2.2014 dhe nr. \*\*\* i vendimit (\*\*\*), datë \*\*\*.4.2018.

proces subjektiv të rivlerësimit, bazuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës, i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Në shtojcën 2, të ligjit nr. 84/2016, në pjesën informuese të deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit, subjektet janë informuar mbi sanksionet në rast mosplotësimi me saktësi dhe vërtetësi të saj. Procesi i rivlerësimit është një procedurë administrative/sanksionuese (dhe asnjëherë një proces penal), e cila ofron të gjitha garancitë e një procesi të rregullt ligjor. Në lidhje me deklarin e pasurisë, ligji nuk ka pasur në qëllim të tij përcaktimin e rrethanave lehtësuese apo rënduese, të lidhura me dashjen apo qëllimin, pasi në të kundërt do të kishte bërë përcaktime të tilla, si në nenin 38 për standardet e kontrollit të figurës”.

## 21. Mosmbulimi i shpenzimeve vjetore të subjektiv nga të ardhura të ligjshme

21.1 Për subjektivin e rivlerësimit, bazuar në analizën financiare mbi të ardhurat dhe shpenzimet, duke marrë në përlllogaritje vetëm ato të ardhura që në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës konsiderohen si të ligjshme, përveçse sa më sipër analizuar, lidhur me vitet kur ka investuar në pasuritë 1 dhe 2<sup>26</sup>, konstatohet gjithashtu se subjektiv nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet vjetore për vitet 2003, 2004 dhe 2005<sup>27</sup>, konkretisht paraqitur në formë tabelare si vijon:

Tabela nr. 3

Viti	2003	2004	2005
Të ardhura nga pagat SR	642.156 lekë	806.657 lekë	87.398 lekë
Të ardhura nga pagat, bashkëshortja	119.000 lekë	-	-
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>761.156 lekë</b>	<b>806.657 lekë</b>	<b>787.398 lekë</b>
Shpenzime jetese	600.000 lekë	600.000 lekë	600.000 lekë
Shpenzime qiraje	144.000 lekë	200.000 lekë	200.000 lekë
Shpenzime për blerje pajisjesh elektroshtëpiake	120.000 lekë	130.000 lekë	
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>864.000 lekë</b>	<b>930.000 lekë</b>	<b>800.000 lekë</b>
Kursime <i>cash</i>			200.000 lekë
Ndryshimi i likuiditeteve në llogaritë bankare	-	-	(12.657,67) lekë
<b>Diferenca për mbulimin e shpenzimeve</b>	<b>(102.844) lekë</b>	<b>(123.343) lekë</b>	<b>(199.944,33) lekë</b>

21.2 Balancat negative midis të ardhurave të ligjshme dhe shpenzimeve, paraqitura më sipër, kanë rezultuar edhe nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, i cili në përfundim ka arsyetuar se: “...balancat financiare negative ndër vite janë të papërfillshme në lidhje me intensitetin e të ardhurave dhe të shpenzimeve të kryera... (f. 36 e vendimit).

<sup>26</sup> Vitet 2006 dhe 2016.

21.3 Komisioneri Publik vlerëson se ky konkluzion përgjithësues i Komisionit, mbi intensitetin e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit, nuk gjen asnjë mbështetje ligjore, pasi në një ekonomi familjare të ardhurat e ligjshme duhet të mbulojnë në çdo rast shpenzimet e kryera për konsum, kursime dhe investime/pasuri. Ky është dhe qëllimi i dispozitës kushtetuese, neni D/3, kur shprehet se: “*subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave*”, në të kundërt nëse raporti i ligjshmërisë së të ardhurave me shpenzimet, kursimet apo investimet e kryera do të ishte i zhdrejtë, atëherë rrjedhimisht do të gjente zbatim neni 61/3, i ligjit nr. 84/2016, pra subjekti do të gjendej në situatën e deklarimit të pamjaftueshëm të pasurisë së tij.

21.4 Sa më sipër provohet se për vitet: 2003, 2004, 2005, 2006 dhe 2016<sup>28</sup>, subjekti nuk mbulon shpenzimet dhe kursimet me të ardhura të ligjshme. Si rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, duke rezultuar kështu për këto vite me pasuri apo të ardhura më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht sipas nenit D/3, të aneksit të Kushtetutës.

### **III. Kërkimi i ankimit**

22. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, nenit, C/2, Ç, D dhe F/7, të aneksit të Kushtetutës, vlerësojmë se ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriterin e pasurisë, Komisioneri Publik, referuar gjendjes së fakteve dhe provave të administruara, nuk krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit arrin një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas nenin 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

23. Shkaqet përcaktuese për të cilat Komisioneri Publik çmon se ky vendim i Komisionit nuk është i drejtë, qëndrojnë në vlerësimin se: (i) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk arrijnë të justifikojnë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe pasurive të deklaruara, referuar nenit D/3, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30, të ligjit nr. 84/2016; (ii) Për vitet 2003, 2004 dhe 2005, 2006 dhe 2016 ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe kursimet e deklaruara, si dhe (iii) ka kryer mosdeklarim të pasurisë dhe deklarim të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, referuar nenit D, pika 1 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61/3, të ligjit nr. 84/2016.

24. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, pa pasur mundësinë ai vetë,

---

<sup>28</sup> Për vitet 2006 dhe 2016 referohu analizës në tabelat nr. 1 dhe nr. 2.

Komisioneri Publik, që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave;

25. Bazuar në nenin D dhe F të aneksit të Kushtetutës, neneve 30-34 dhe pika 3, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

26. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 58, datë 1.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, zotit Besnik Muçi.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Darjel SINA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_ prot.

Tiranë, më 1.10.2019

**Lënda:** Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 1.10.2019, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit z. Besnik Muçi

### **Të nderuar anëtarë të trupit gjykues!**

Pasi u njohëm me shpjegimet, prapësimet dhe provat e dorëzuara nga ana e subjektit të rivlerësimit në seancën e mëparshme të datës 21.9.2019, Komisioneri Publik, në analizë të përmbajtjes së tyre në raport me shkaqet e ngritura në ankim, vlerëson:

**1.** Së pari, kërkimi i subjektit të rivlerësimit për mospranimin e ankimit, pasi pretendon se ankimi ka mbërritur pranë Kolegjit 90 ditë pas dhënies së vendimit nr. 58/2018 të Komisionit, pra 45 ditë tej afatit ligjor të përcaktuar nga nenet 55/7 dhe 63/1, të ligjit nr. 84/2016, nuk gjen asnjë mbështetje ligjore.

1.1 Bazuar në nenin F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ka të drejtë të ushtrojë ankim pranë Kolegjit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Vendimi nr. 58, datë 1.8.2018, i Komisionit është njoftuar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë më datë 17.10.2018. Komisioneri Publik, brenda afatit ligjor prej 15 ditëve nga data e njoftimit, ka ushtruar të drejtën e ankimit, paraqitur me nr. 428/5 prot., datë 31.10.2018, depozituar pranë Komisionit në mbështetje të nenit 63, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

### **2. Lidhur me shkaqet e ankimit për pasurinë 1**

Kujtojmë se kemi parashtruar se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të kursimeve personale të deklaruara, si dhe burimin e ligjshëm të huave të deklaruara nga personat e tjerë të lidhur, duke rezultuar kështu në pamjaftueshmëri në mbulimin me burime të ligjshme të kësaj pasurie.

2.1 Për pamjaftueshmërinë në deklaram dhe pamundësinë për të justifikuar bindshëm me burime të ligjshme, kursimet personale të deklaruara në shumën 200.000 lekë, në vitin 2005, rezulton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë për të provuar të kundërtën (sikurse dhe për vitet 2003 dhe 2004).

2.2 Lidhur me pamundësinë e personave të tjerë të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme shumat e deklaruara të dhëna hua subjektit, të deklaruara si burim krijimi i pasurisë, për prapësimet dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, analizojmë si më poshtë:

2.2.1 *Për huan në shumën 500.000 lekë*, marrë nga babai, burimi i deklaruar në DV-2006, D-Vett. dhe gjatë hetimit administrativ është: (i) të ardhura nga puna në bujqësi dhe (ii) nga emigracioni i vëllait të subjektit.

(i) *Për të ardhurat nga puna në bujqësi*, subjekti, në parashtrimet në seancën e datës 21.9.2019, ndër të tjera, argumentoi se aktet e marra nga Njësia Administrative \*\*\* kanë vlerë provuese, duke qenë se ato janë dokumente të marra nga institucionet shtetërore dhe, si të tilla, provojnë në mënyrë shteruese faktet që ato iu referohen<sup>1</sup>. Për më tepër, subjekti pretendon që të ardhurat e përfituara nga shitja e prodhimeve bujqësore janë të përjashtuara nga tatimi, bazuar në nenin 8, pika 11, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, dhe ligjit për pushtetin vendor.

Në vlerësimin e Komisionerit Publik, provat dhe argumentet e paraqitura nga subjekti për sa më sipër, nuk provojnë të kundërtën e shkakut të ankimit. Subjekti interpreton në mënyrë të gabuar nenin 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku në pikën 11 të tij, ndër të tjera, listohen si të ardhura të përjashtuara nga detyrimi për të paguar tatim fitimi edhe *të ardhurat e realizuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore nga një fermer i regjistruar tek një fermer tjetër apo një person fizik a juridik, që kryen aktivitet bujqësor*. Sipas këtij përcaktimi, përjashtimi nuk vepron mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti bujqësor, por vetëm mbi të ardhurat e realizuara nga tjetërsimi i tokës bujqësore.

Në prapësimet e tij, subjekti referon dhe ligjin për pushtetin vendor, si dhe ligjin nr. 112/2016, i cili ka ndryshuar ligjin nr. 9920/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nenin 5, germa “j”, sipas të cilit, shitësit ambulante nuk kanë pasur në atë kohë detyrimin për të pasur një vendndodhje fikse apo detyrimin ligjor që të regjistroheshin si person tregtar. Gjithashtu, për të provuar burimin e ligjshëm të huas nga babai, subjekti ka paraqitur dhe vërtetimet nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Korçë, për të vetëpunësuarit në bujqësi, sipas së cilave, prindërit e subjektit rezultojnë si të vetëpunësuar në bujqësi që nga viti 1994 (babai) dhe që nga viti 1997 (nëna), të cilët derdhin masën e kontributit, sipas përcaktimeve ligjore.

Në vlerësimin e Komisionerit Publik, dokumentet si më sipër provojnë faktin e vetëpunësimit në bujqësi të prindërve të subjektit, por jo të ardhurat e realizuara dhe nëse këto të ardhura plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës. Shpjegimi që subjekti bën për të llogaritur të ardhurat e realizuara nga prindërit, bazuar në pagën minimale për të cilën janë paguar detyrimet ndaj sigurimeve shoqërore, të cilat më pas subjekti pretendon të llogariten në të ardhurat e ligjshme të prindërve, nuk gjejnë asnjë mbështetje ligjore.

Për burimin e ligjshëm të huas së marrë nga babai, subjekti ka depozituar dhe një vërtetim për bazën e vlerësuar, lëshuar nga Komuna \*\*\*, mbi të ardhurat e siguruara nga punësimi i së motrës, znj. \*\*\*.\*\*\*, në shumën totale rreth 565.000 lekë, për periudhën 2002-2005, kohë në të cilën, sipas pretendimeve të subjektit, këto të ardhura kanë shërbyer në krijimin e kursimeve të deklaruara nga familja e babait të tij.

---

<sup>1</sup> Për më tepër referohuni në prg. 4.1.2 (f. 5), të parashtrimeve të subjektit.

Rezulton se ky burim të ardhurash nuk është deklaruar asnjëherë në deklaratat periodike dhe në atë Vetting, sikurse dhe gjatë hetimit administrativ. Rrjedhimisht, ky burim nuk mund të përdoret në vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për huan e marrë nga babai.

Duke përfunduar, në vlerësim të Komisionerit Publik rezulton se për të ardhurat e deklaruara nga puna në bujqësi e babait, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument, provë të re bindëse për të kundërtën e shkakut të ankimit.

(ii) Për të ardhurat nga emigracioni i të vëllait, rezulton se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion, prova të reja. Në seancën e datës 21.9.2019, subjekti ka pretenduar mbi të ardhurat e vëllait nga biznesi “furrë buke”, duke paraqitur disa dokumente mbi regjistrimin e këtij aktiviteti në pronësi të të vëllait, kontrata të lidhura nga ky aktivitet me Komisaratin e Policisë, Pogradec, lëvizjet e llogarisë bankare të këtij biznesi, sipas së cilave rezulton se në vitin 2005 është arkëtuar nga kontrata me Komisaratin e Policisë Pogradec, në total, shuma prej 711.300 lekësh (duke përfshirë këtu dhe detyrime nga viti 2004).

Rezulton se ky burim të ardhurash nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti në deklaratat periodike dhe në atë Vetting, sikurse dhe gjatë hetimit administrativ. Rrjedhimisht, ky burim nuk mund të përdoret në vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të ardhurat nga emigracioni i të vëllait.

Konstatohet, gjithashtu, se për të ardhurat e pretenduara nga ky aktivitet i të vëllait, subjekti nuk ka provuar pagimin e detyrimeve tatimore, si dhe duke marrë në konsideratë parashtrimet e subjektit, se në shpenzimet e personave të tjerë të lidhur duhet të llogariten dhe shpenzimet për hapjen e aktivitetit, të deklaruara në vlerën 10.000 euro, ky fakt do të ndikonte në pamundësinë financiare të vëllait të subjektit për të mbuluar huan.

2.2.2 Për huan nga xhaxhai, shtetasi \*\*\*.\*\*\*, në shumën **3.000** euro, me burim të deklaruar: (i) emigracioni dhe (ii) të ardhura nga puna në bujqësi.

(i) Për sa i përket burimit të deklaruar kursime nga emigracioni, subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë të re.

(ii) Për sa i përket të ardhurave nga puna bujqësi, subjekti referon të njëjtën bazë ligjore si më sipër trajtuar mbi të ardhurat nga puna në bujqësi e babait të tij, për të cilat, për të njëjtat shkaqe sikundër argumentuar më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik rezulton se subjekti nuk arrin të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës.

Për të provuar të ardhurat e fituara nga familja e xhaxhait, subjekti ka paraqitur dhe një vërtetimin me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2019, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Korçë, sipas të cilit vërtetohet se shtetasi \*\*\*.\*\*\*, për periudhën 1991- janar 2006 (kohë në të cilën është deklaruar huaja), ka realizuar të ardhura nga pensioni i pleqërisë, në shumën 1.133.227 lekë, të cilat në vlerësimin e Komisionerit Publik nuk mund të konsiderohen të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet vetjake dhe huan e dhënë subjektit.

2.3 Për huan nga e motra dhe bashkëshorti i saj, në shumën 6.000 euro, me burim krijimi të deklaruar nga emigracioni në Mbretërinë e Bashkuar.

2.3.1 Nga provat e paraqitura në seancën e datës 21.9.2019, rezulton se bashkëshorti i motrës së subjektit të rivlerësimit është regjistruar në skemën e sigurimeve kombëtare të detyrueshme

në Mbretërinë e Bashkuar, në datë \*\*\*.8.1997. Nga dokumentet e vëna në dispozicion, rezulton se ky i fundit ka realizuar të ardhura të konsiderueshme, për të cilat ka dokumentuar nga autoritetet përgjegjëse dhe pagimin e detyrimeve tatimore<sup>2</sup>.

2.3.2 Lidhur me shpenzimet e bashkëshortit të motrës, z. \*\*\*.\*\*\*, gjatë qëndrimit në emigracion, subjekti ka pretenduar se ky i fundit ka banuar në banesa sociale, ku një pjesë e qirasë përballohet nga shteti dhe, për të provuar këtë, ka vënë në dispozicion dhe kontratën e qirasë së banesës, nënshkruar nga shtetasi \*\*\*.\*\*\* dhe “\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*”. Në këtë dokument të paraqitur në gjuhën angleze, nuk specifikohet shuma e qirasë mujore, ndërkohë subjekti ka deklaruar se, duke qenë banesë sociale, qiraja mujore varion nga 200-250 paund.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga subjekti, referuar standardit të jetesës në qytetin anglez përkatës, në mungesë të të dhënave të sakta mbi shpenzimet e jetesës të së motrës së subjektit dhe bashkëshortit të saj, nisur nga koha e gjatë e emigracionit, e vërtetuar me aktet e sjella nga subjekti, përbërja familjare e personave të tjerë të lidhur dhe faktit se shuma e dhënë hua është në vlerën e rreth 4.116 paund<sup>3</sup>, në vlerësimin e Komisionerit Publik, kjo shumë mbulohet me burime të ligjshme të personave të tjerë të lidhur, referuar nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

### **3. Lidhur me transaksionet e evidentuara të kryera nga subjekti i rivlerësimit në llogarinë e së motrës, pranë \*\*\* Bank**

Subjekti ka deklaruar se burimi i transaksioneve ka qenë nga të ardhurat nga emigracioni i kunatit të tij, \*\*\*.\*\*\*, me qëllim depozitimin e shumës së nevojshme për garanci në llogarinë bankare të së motrës së subjektit, për efekt të marrjes së vizës të qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar. Transaksionet janë kryer nga subjekti, pasi dispononte prokurë për llogarinë e së motrës.

Duke marrë në konsideratë se subjekti nuk e ka deklaruar këtë marrëdhënie në formularët e deklarimit pranë ILDKPKI-së, nuk provohet me asnjë dokument apo rrethanë mënyra e kalimit të këtyre likuiditeteve nga Mbretëria e Bashkuar për në Shqipëri, referuar udhëzimit të ILDKPKI-së nr. 4095, datë 10.10.2016, pretendimet e subjektit për këtë shkak ankimi nuk janë bindëse.

### **4. Lidhur me burimin e të ardhurave të ligjshme, të personave të tjerë të lidhur, shtetasve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*.\*\*\*.**

4.1 Subjekti ka depozituar dokumentacion të lëshuar nga autoritetet turke (mbi pagesën e sigurimeve shoqërore mbi të ardhurat), si dhe borderotë (provë e re) nga shoqëria “\*\*\*”, përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. Të ardhurat e pasqyruara në borderotë e shoqërisë përputhen me të ardhurat e deklaruara dhe të konfirmuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në shtetin turk.

4.2 Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se të ardhurat neto të realizuara nga personat e tjerë të lidhur, për periudhën janar 2013 – prill 2016 (pasi në maj është kryer transferta bankare), janë në shumën 122.388 lira turke ose 4.623.800 lekë<sup>4</sup> (katër milionë e gjashtëqind e njëzet e tre mijë e tetëqind). Shuma e dhënë hua në vlerën 15.000 euro

<sup>2</sup> Për periudhën deri në vitin 2005, në shumën rreth 20.800 paund (neto), ndërsa të ardhurat neto të realizuara nga punësimi për vitin 2005/2006 janë në shumën 18.332 paund.

<sup>3</sup> Konvertuar me kursin mesatar të arkivit të Bankës së Shqipërisë për muajin janar 2006.

<sup>4</sup> Konvertuar me kursin mesatar të lirës turke të vitit 2016.

ose 54.540 lira turke (2.060.000, dy milionë e gjashtëdhjetë mijë lekë) rezulton se zë rreth 45% të të ardhurave totale të familjes së personave të tjerë të lidhur, për periudhën 2013-2016.

4.3 Subjekti, në parashtrimet e seancës së datës 21.9.2019, ka analizuar aftësinë financiare të personave të tjerë të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua. Për të llogaritur shpenzimet minimale të jetesës së personave të tjerë të lidhur, subjekti ka referuar të dhënat e faqes zyrtare, që mat nivelin e shpenzimeve minimale në shtetin turk, duke marrë në konsideratë nivelin më të ulët të shpenzimeve të matshme, në të cilin përfshihen vetëm shpenzimet mujore për ushqim, për një familje me katër persona.

4.4 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, të dhënat e referuara nga subjekti mbi limitin minimal të shpenzimeve janë në nivele tepër të ulëta, për t'u konsideruar në analizën financiare të personave të tjerë të lidhur<sup>5</sup>. Në rastin më të mirë, nisur nga fakti se subjekti ka provuar me dokumentacion se personat e tjerë të lidhur jetojnë në shtëpinë e të afërmeve, pa pagesë, në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpenzimet e jetesës për personat e tjerë të lidhur duhet të llogariten si një mesatare e thjeshtë aritmetike e dy niveleve të përcaktuara mbi shpenzimet e jetesës në shtetin turk<sup>6</sup>.

4.5 Nga sa më sipër, duke qenë se shuma e huas së dhënë subjektit është sa rreth 45% e totalit të të ardhurave neto nga pagat e personave të tjerë të lidhur, për periudhën 2013-2016, rezulton se subjekti nuk ka arritur të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, në kuptim të nenit 32/4, të ligjit nr. 84/2016, dhe nenit D të aneksit të Kushtetutës.

## **5. Lidhur me shkakun e ankimit, për mosdeklarim të pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të**

Prapësimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk gjejnë asnjë mbështetje ligjore për të rrëzuar këtë shkak ankimi. Referenca ligjore në ligjin nr. 8337/1998 dhe ajo në udhëzimin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nuk marrin vlerë në vlerësimin e këtij shkak. Në vlerësim të Komisionerit Publik, nuk ka asnjë rrethanë ligjore që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të të mos deklaronin saktësisht dhe mjaftueshmërisht pasuritë e tyre në pronësi dhe bashkëpronësi apo të drejtat mbi to. Neni D, pikat 1, 2 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, neni 32, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit 2017, detyron subjektin e rivlerësimit për deklarimin saktësisht dhe mjaftueshmërisht të “pasurisë” së tij dhe personave të lidhur me të, si dhe “burimin” në momentin e krijimit të saj. Me burim, në këtë rast, përfshihet si origjina, pra shkak apo veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, ashtu dhe mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Darjel SINA**

<sup>5</sup> Në të dhënat e analizuara duhet të merret në konsideratë ose niveli i varfërisë, i cili sipas të dhënave zyrtare të shtetit turk, përveç shpenzimeve për ushqime, llogarit dhe shpenzimet për qira, veshmbathje, energji, ujë, gaz etj.

<sup>6</sup> Mesatarja e treguesve “limit of hunger” dhe “limit of poverty” sipas burimit: <http://www.turkis.org.tr/LIMIT-OF-HUNGER-AND-POVERTY>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_ prot.

Tiranë, më 1.10.2019

**Lënda:** Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 1.10.2019, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit z. Besnik Muçi

### **Të nderuar anëtarë të trupit gjykues!**

Pasi u njohëm me shpjegimet, prapësimet dhe provat e dorëzuara nga ana e subjektit të rivlerësimit në seancën e mëparshme të datës 21.9.2019, Komisioneri Publik, në analizë të përmbajtjes së tyre në raport me shkaqet e ngritura në ankim, vlerëson:

**1.** Së pari, kërkimi i subjektit të rivlerësimit për mospranimin e ankimit, pasi pretendon se ankimi ka mbërritur pranë Kolegjit 90 ditë pas dhënies së vendimit nr. 58/2018 të Komisionit, pra 45 ditë tej afatit ligjor të përcaktuar nga nenet 55/7 dhe 63/1, të ligjit nr. 84/2016, nuk gjen asnjë mbështetje ligjore.

1.1 Bazuar në nenin F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ka të drejtë të ushtrojë ankim pranë Kolegjit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Vendimi nr. 58, datë 1.8.2018, i Komisionit është njoftuar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë më datë 17.10.2018. Komisioneri Publik, brenda afatit ligjor prej 15 ditëve nga data e njoftimit, ka ushtruar të drejtën e ankimit, paraqitur me nr. 428/5 prot., datë 31.10.2018, depozituar pranë Komisionit në mbështetje të nenit 63, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

### **2. Lidhur me shkaqet e ankimit për pasurinë 1**

Kujtojmë se kemi parashtruar se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të kursimeve personale të deklaruara, si dhe burimin e ligjshëm të huave të deklaruara nga personat e tjerë të lidhur, duke rezultuar kështu në pamjaftueshmëri në mbulimin me burime të ligjshme të kësaj pasurie.

2.1 Për pamjaftueshmërinë në deklaram dhe pamundësinë për të justifikuar bindshëm me burime të ligjshme, kursimet personale të deklaruara në shumën 200.000 lekë, në vitin 2005, rezulton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë për të provuar të kundërtën (sikurse dhe për vitet 2003 dhe 2004).

2.2 Lidhur me pamundësinë e personave të tjerë të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme shumat e deklaruara të dhëna hua subjektit, të deklaruara si burim krijimi i pasurisë, për prapësimet dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, analizojmë si më poshtë:

2.2.1 *Për huan në shumën 500.000 lekë*, marrë nga babai, burimi i deklaruar në DV-2006, D-Vett. dhe gjatë hetimit administrativ është: (i) të ardhura nga puna në bujqësi dhe (ii) nga emigracioni i vëllait të subjektit.

(i) *Për të ardhurat nga puna në bujqësi*, subjekti, në parashtrimet në seancën e datës 21.9.2019, ndër të tjera, argumentoi se aktet e marra nga Njësia Administrative \*\*\* kanë vlerë provuese, duke qenë se ato janë dokumente të marra nga institucionet shtetërore dhe, si të tilla, provojnë në mënyrë shteruese faktet që ato iu referohen<sup>1</sup>. Për më tepër, subjekti pretendon që të ardhurat e përfituara nga shitja e prodhimeve bujqësore janë të përjashtuara nga tatimi, bazuar në nenin 8, pika 11, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, dhe ligjit për pushtetin vendor.

Në vlerësimin e Komisionerit Publik, provat dhe argumentet e paraqitura nga subjekti për sa më sipër, nuk provojnë të kundërtën e shkakut të ankimit. Subjekti interpreton në mënyrë të gabuar nenin 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku në pikën 11 të tij, ndër të tjera, listohen si të ardhura të përjashtuara nga detyrimi për të paguar tatim fitimi edhe *të ardhurat e realizuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore nga një fermer i regjistruar tek një fermer tjetër apo një person fizik a juridik, që kryen aktivitet bujqësor*. Sipas këtij përcaktimi, përjashtimi nuk vepron mbi të ardhurat e realizuara nga aktiviteti bujqësor, por vetëm mbi të ardhurat e realizuara nga tjetërsimi i tokës bujqësore.

Në prapësimet e tij, subjekti referon dhe ligjin për pushtetin vendor, si dhe ligjin nr. 112/2016, i cili ka ndryshuar ligjin nr. 9920/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nenin 5, germa “j”, sipas të cilit, shitësit ambulantë nuk kanë pasur në atë kohë detyrimin për të pasur një vendndodhje fikse apo detyrimin ligjor që të regjistroheshin si person tregtar. Gjithashtu, për të provuar burimin e ligjshëm të huas nga babai, subjekti ka paraqitur dhe vërtetimet nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Korçë, për të vetëpunësuarit në bujqësi, sipas së cilave, prindërit e subjektit rezultojnë si të vetëpunësuar në bujqësi që nga viti 1994 (babai) dhe që nga viti 1997 (nëna), të cilët derdhin masën e kontributit, sipas përcaktimeve ligjore.

Në vlerësimin e Komisionerit Publik, dokumentet si më sipër provojnë faktin e vetëpunësimit në bujqësi të prindërve të subjektit, por jo të ardhurat e realizuara dhe nëse këto të ardhura plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës. Shpjegimi që subjekti bën për të llogaritur të ardhurat e realizuara nga prindërit, bazuar në pagën minimale për të cilën janë paguar detyrimet ndaj sigurimeve shoqërore, të cilat më pas subjekti pretendon të llogariten në të ardhurat e ligjshme të prindërve, nuk gjejnë asnjë mbështetje ligjore.

Për burimin e ligjshëm të huas së marrë nga babai, subjekti ka depozituar dhe një vërtetim për bazën e vlerësuar, lëshuar nga Komuna \*\*\*, mbi të ardhurat e siguruara nga punësimi i së motrës, znj. \*\*\*.\*\*\*, në shumën totale rreth 565.000 lekë, për periudhën 2002-2005, kohë në të cilën, sipas pretendimeve të subjektit, këto të ardhura kanë shërbyer në krijimin e kursimeve të deklaruara nga familja e babait të tij.

---

<sup>1</sup> Për më tepër referohuni në prg. 4.1.2 (f. 5), të parashtrimeve të subjektit.

Rezulton se ky burim të ardhurash nuk është deklaruar asnjëherë në deklaratat periodike dhe në atë Vetting, sikurse dhe gjatë hetimit administrativ. Rrjedhimisht, ky burim nuk mund të përdoret në vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për huan e marrë nga babai.

Duke përfunduar, në vlerësim të Komisionerit Publik rezulton se për të ardhurat e deklaruara nga puna në bujqësi e babait, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokument, provë të re bindëse për të kundërtën e shkakut të ankimit.

(ii) Për të ardhurat nga emigracioni i të vëllait, rezulton se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion, prova të reja. Në seancën e datës 21.9.2019, subjekti ka pretenduar mbi të ardhurat e vëllait nga biznesi “furrë buke”, duke paraqitur disa dokumente mbi regjistrimin e këtij aktiviteti në pronësi të të vëllait, kontrata të lidhura nga ky aktivitet me Komisaratin e Policisë, Pogradec, lëvizjet e llogarisë bankare të këtij biznesi, sipas së cilave rezulton se në vitin 2005 është arkëtuar nga kontrata me Komisaratin e Policisë Pogradec, në total, shuma prej 711.300 lekësh (duke përfshirë këtu dhe detyrime nga viti 2004).

Rezulton se ky burim të ardhurash nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti në deklaratat periodike dhe në atë Vetting, sikurse dhe gjatë hetimit administrativ. Rrjedhimisht, ky burim nuk mund të përdoret në vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të ardhurat nga emigracioni i të vëllait.

Konstatohet, gjithashtu, se për të ardhurat e pretenduara nga ky aktivitet i të vëllait, subjekti nuk ka provuar pagimin e detyrimeve tatimore, si dhe duke marrë në konsideratë parashtrimet e subjektit, se në shpenzimet e personave të tjerë të lidhur duhet të llogariten dhe shpenzimet për hapjen e aktivitetit, të deklaruara në vlerën 10.000 euro, ky fakt do të ndikonte në pamundësinë financiare të vëllait të subjektit për të mbuluar huan.

2.2.2 Për huan nga xhaxhai, shtetasi \*\*\*.\*\*\*, në shumën **3.000** euro, me burim të deklaruar: (i) emigracioni dhe (ii) të ardhura nga puna në bujqësi.

(i) Për sa i përket burimit të deklaruar kursime nga emigracioni, subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë të re.

(ii) Për sa i përket të ardhurave nga puna bujqësi, subjekti referon të njëjtën bazë ligjore si më sipër trajtuar mbi të ardhurat nga puna në bujqësi e babait të tij, për të cilat, për të njëjtat shkaqe sikundër argumentuar më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik rezulton se subjekti nuk arrin të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës.

Për të provuar të ardhurat e fituara nga familja e xhaxhait, subjekti ka paraqitur dhe një vërtetimin me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2019, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Korçë, sipas të cilit vërtetohet se shtetasi \*\*\*.\*\*\*, për periudhën 1991- janar 2006 (kohë në të cilën është deklaruar huaja), ka realizuar të ardhura nga pensioni i pleqërisë, në shumën 1.133.227 lekë, të cilat në vlerësimin e Komisionerit Publik nuk mund të konsiderohen të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet vetjake dhe huan e dhënë subjektit.

2.3 Për huan nga e motra dhe bashkëshorti i saj, në shumën 6.000 euro, me burim krijimi të deklaruar nga emigracioni në Mbretërinë e Bashkuar.

2.3.1 Nga provat e paraqitura në seancën e datës 21.9.2019, rezulton se bashkëshorti i motrës së subjektit të rivlerësimit është regjistruar në skemën e sigurimeve kombëtare të detyrueshme



në Mbretërinë e Bashkuar, në datë \*\*\*.8.1997. Nga dokumentet e vëna në dispozicion, rezulton se ky i fundit ka realizuar të ardhura të konsiderueshme, për të cilat ka dokumentuar nga autoritetet përgjegjëse dhe pagimin e detyrimeve tatimore<sup>2</sup>.

2.3.2 Lidhur me shpenzimet e bashkëshortit të motrës, z. \*\*\*.\*\*\*, gjatë qëndrimit në emigracion, subjekti ka pretenduar se ky i fundit ka banuar në banesa sociale, ku një pjesë e qirasë përballohet nga shteti dhe, për të provuar këtë, ka vënë në dispozicion dhe kontratën e qirasë së banesës, nënshkruar nga shtetasi \*\*\*.\*\*\* dhe “\*\*\*.\*\*\*.\*\*\*”. Në këtë dokument të paraqitur në gjuhën angleze, nuk specifikohet shuma e qirasë mujore, ndërkohë subjekti ka deklaruar se, duke qenë banesë sociale, qiraja mujore varion nga 200-250 paund.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga subjekti, referuar standardit të jetesës në qytetin anglez përkatës, në mungesë të të dhënave të sakta mbi shpenzimet e jetesës të së motrës së subjektit dhe bashkëshortit të saj, nisur nga koha e gjatë e emigracionit, e vërtetuar me aktet e sjella nga subjekti, përbërja familjare e personave të tjerë të lidhur dhe faktit se shuma e dhënë hua është në vlerën e rreth 4.116 paund<sup>3</sup>, në vlerësimin e Komisionerit Publik, kjo shumë mbulohet me burime të ligjshme të personave të tjerë të lidhur, referuar nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

### **3. Lidhur me transaksionet e evidentuara të kryera nga subjekti i rivlerësimit në llogarinë e së motrës, pranë \*\*\* Bank**

Subjekti ka deklaruar se burimi i transaksioneve ka qenë nga të ardhurat nga emigracioni i kunatit të tij, \*\*\*.\*\*\*, me qëllim depozitimin e shumës së nevojshme për garanci në llogarinë bankare të së motrës së subjektit, për efekt të marrjes së vizës të qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar. Transaksionet janë kryer nga subjekti, pasi dispononte prokurë për llogarinë e së motrës.

Duke marrë në konsideratë se subjekti nuk e ka deklaruar këtë marrëdhënie në formularët e deklarimit pranë ILDKPKI-së, nuk provohet me asnjë dokument apo rrethanë mënyra e kalimit të këtyre likuiditeteve nga Mbretëria e Bashkuar për në Shqipëri, referuar udhëzimit të ILDKPKI-së nr. 4095, datë 10.10.2016, pretendimet e subjektit për këtë shkak ankimi nuk janë bindëse.

### **4. Lidhur me burimin e të ardhurave të ligjshme, të personave të tjerë të lidhur, shtetasve \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*.\*\*\*.**

4.1 Subjekti ka depozituar dokumentacion të lëshuar nga autoritetet turke (mbi pagesën e sigurimeve shoqërore mbi të ardhurat), si dhe borderotë (provë e re) nga shoqëria “\*\*\*”, përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. Të ardhurat e pasqyruara në borderotë e shoqërisë përputhen me të ardhurat e deklaruara dhe të konfirmuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore në shtetin turk.

4.2 Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se të ardhurat neto të realizuara nga personat e tjerë të lidhur, për periudhën janar 2013 – prill 2016 (pasi në maj është kryer transferta bankare), janë në shumën 122.388 lira turke ose 4.623.800 lekë<sup>4</sup> (katër milionë e gjashtëqind e njëzet e tre mijë e tetëqind). Shuma e dhënë hua në vlerën 15.000 euro

<sup>2</sup> Për periudhën deri në vitin 2005, në shumën rreth 20.800 paund (neto), ndërsa të ardhurat neto të realizuara nga punësimi për vitin 2005/2006 janë në shumën 18.332 paund.

<sup>3</sup> Konvertuar me kursin mesatar të arkivit të Bankës së Shqipërisë për muajin janar 2006.

<sup>4</sup> Konvertuar me kursin mesatar të lirës turke të vitit 2016.

ose 54.540 lira turke (2.060.000, dy milionë e gjashtëdhjetë mijë lekë) rezulton se zë rreth 45% të të ardhurave totale të familjes së personave të tjerë të lidhur, për periudhën 2013-2016.

4.3 Subjekti, në parashtrimet e seancës së datës 21.9.2019, ka analizuar aftësinë financiare të personave të tjerë të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua. Për të llogaritur shpenzimet minimale të jetesës së personave të tjerë të lidhur, subjekti ka referuar të dhënat e faqes zyrtare, që mat nivelin e shpenzimeve minimale në shtetin turk, duke marrë në konsideratë nivelin më të ulët të shpenzimeve të matshme, në të cilin përfshihen vetëm shpenzimet mujore për ushqim, për një familje me katër persona.

4.4 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, të dhënat e referuara nga subjekti mbi limitin minimal të shpenzimeve janë në nivele tepër të ulëta, për t'u konsideruar në analizën financiare të personave të tjerë të lidhur<sup>5</sup>. Në rastin më të mirë, nisur nga fakti se subjekti ka provuar me dokumentacion se personat e tjerë të lidhur jetojnë në shtëpinë e të afërmeve, pa pagesë, në vlerësimin e Komisionerit Publik, shpenzimet e jetesës për personat e tjerë të lidhur duhet të llogariten si një mesatare e thjeshtë aritmetike e dy niveleve të përcaktuara mbi shpenzimet e jetesës në shtetin turk<sup>6</sup>.

4.5 Nga sa më sipër, duke qenë se shuma e huas së dhënë subjektit është sa rreth 45% e totalit të të ardhurave neto nga pagat e personave të tjerë të lidhur, për periudhën 2013-2016, rezulton se subjekti nuk ka arritur të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, në kuptim të nenit 32/4, të ligjit nr. 84/2016, dhe nenit D të aneksit të Kushtetutës.

## **5. Lidhur me shkakun e ankimit, për mosdeklarim të pasurisë nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të**

Prapësimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk gjejnë asnjë mbështetje ligjore për të rrëzuar këtë shkak ankimi. Referenca ligjore në ligjin nr. 8337/1998 dhe ajo në udhëzimin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nuk marrin vlerë në vlerësimin e këtij shkak. Në vlerësim të Komisionerit Publik, nuk ka asnjë rrethanë ligjore që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të të mos deklaronin saktësisht dhe mjaftueshmërisht pasuritë e tyre në pronësi dhe bashkëpronësi apo të drejtat mbi to. Neni D, pikat 1, 2 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, neni 32, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së datë 10.10.2016, si dhe formulari i deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit 2017, detyron subjektin e rivlerësimit për deklarimin saktësisht dhe mjaftueshmërisht të “pasurisë” së tij dhe personave të lidhur me të, si dhe “burimin” në momentin e krijimit të saj. Me burim, në këtë rast, përfshihet si origjina, pra shkak apo veprimi i ligjshëm që passjell disponimin dhe të drejtat pronësore të pasurisë, ashtu dhe mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Darjel SINA**

---

<sup>5</sup> Në të dhënat e analizuar duhet të merret në konsideratë ose niveli i varfërisë, i cili sipas të dhënave zyrtare të shtetit turk, përveç shpenzimeve për ushqime, llogarit dhe shpenzimet për qira, veshmbathje, energji, ujë, gaz etj.

<sup>6</sup> Mesatarja e treguesve “limit of hunger” dhe “limit of poverty” sipas burimit: <http://www.turkis.org.tr/LIMIT-OF-HUNGER-AND-POVERTY>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERET PUBLIKE

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 16.10.2019

**Lënda:** Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 16.10.2019, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit z. Besnik Muçi

**Të nderuar anëtarë të trupit gjykues!**

Në vijim të vendimit të ndërmjetëm, në seancën gjyqësore të datës 1.10.2019, për marrjen si provë të dokumentit të përcjellë nga ana e DSIK-së, si dhe shkresës së datës 10.10.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, drejtuar Institucionit të Komisionerëve Publikë dhe subjektit të rivlerësimit, z. Muçi, në vijim paraqesim qëndrimin e Komisionerit Publik në lidhje me përmbajtjen e kësaj prove të administruar, tashmë e deklasifikuar plotësisht sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi për deklasifikimin e informacionit të klasifikuar: “sekret shtetëror”.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi në tërësi i përmbajtjes së informacionit të DSIK-së, i cili në thelb përmban dokumentacion të përcjellë nga ana e Drejtorisë Gjyqësore e Prokurorisë së Përgjithshme, për personat e tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, rrethanat dhe faktet e paraqitura në të, në vështrim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, mund të shërbejnë në vlerësimin tërësor të çështjes dhe procedurave rivlerësuese për subjektin e rivlerësimit.

Konstatojmë se personat e tjerë të lidhur me subjektin, të proceduar penalisht për veprat penale të përmendura në këtë informacion, nuk përmbushin kushtet për t’u cilësuar si persona të përfshirë në krimin e organizuar e, për rrjedhojë, të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, e të vetme, në vlerësimin e kriterit të figurës për subjektin e rivlerësimit, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuar në nenin DH, të aneksit të Kushtetutës.

Por Komisioneri Publik çmon se ky informacion, në konsideratë të raportit dhe të marrëdhënieve të pranuara edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, sikurse dhe nga rrethanat e dala nga vlerësimi i kriterit për kontrollin e pasurisë, ku provohet se subjekti ka pasur marrëdhënie interesi dhe pasuror me personin tjetër të lidhur, që rezulton i proceduar penalisht, shtetasi \*\*\*.\*\*\*, sikurse deklaron dhe në deklaratën Vetting, detyrim ndaj këtij shtetasi në vlerën 21.000 euro, mund të shërbejë si rrethanë dhe argument se subjekti i rivlerësimit mund të vihet lehtësisht nën presionin e strukturave kriminale, në referim të nenit 37, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016.

Gjithsesi, vlerësimin e kësaj rrethane, raportin dhe ndikimin që ajo ka në vlerësimin tërësor të çështjes dhe të procedurave rivlerësuese për subjektin e rivlerësimit, Komisioneri Publik ia lë në çmim këtij Trupi të Nderuar.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Darjel SINA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERET PUBLIKE

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 7.11.2019

**Lënda:** Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 7.11.2019, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit z. Besnik Muçi

**Të nderuar anëtarë të trupit gjykues!**

Në seancën e mëparshme gjyqësore të datës 4.11.2019, pasi subjekti i rivlerësimit kërkoi administrimin e disa provave, vendosët lejimin e marrjes si provë të 10 akteve<sup>1</sup>, ndërkohë për disa të tjera, me të drejtë, i vlerësuar si të palejueshme në pikëpamje të formës dhe të përmbajtjes së tyre për t'u administruar, në respektim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile.

Lidhur me provat e pranuar, referuar objektit të tyre dhe faktit se çfarë kërkon të provojë subjekti i rivlerësimit, Komisioneri Publik çmon se ato nuk janë relevante për sa i takon zgjidhjes së çështjes, si dhe nuk kanë asnjë vlerë përcaktuese për të kundërtën e shkaqeve të ankimit.

Për korrespondencën e ndjekur nga subjekti i rivlerësimit me ILDKPKI-në, specifikisht shkresa me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2019, me objekt metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve për jetesë, rezulton se referohet vetëm linku i faqes zyrtare të INSTAT-it, çka nuk provon një rezultat të ndryshëm nga ai i paraqitur në ankim.

Lidhur me këtë fakt, sjellim në vëmendje që vetë subjekti i rivlerësimit, në seancën e datës 20.9.2019, duke argumentuar mbi parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk e ka kundërshtuar metodologjinë dhe rezultatet e dala lidhur me shpenzimet e jetesës.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Darjel SINA**

<sup>1</sup> - Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 731, datë 8.4.2015, lidhur me shtetasin \*\*\*.\*\*\*.

- Vërtetim i gjendjes gjyqësore, datë \*\*\*09.2019, për shtetasin \*\*\*. \*\*\*.

- Kërkesë e subjektit drejtuar ILDKPKI-së dhe shkresa e kësaj të fundit me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2019.

- Tri mandatpagesa të \*\*\*Bank, të datës \*\*\*.12.2017, \*\*\*.12.2018 dhe \*\*\*.10.2019.

- Kontratë kredi bankare konsumatore me \*\*\*Bank, datë \*\*\*.10.2019.

- Kontratë kredi me kufi (OVD) me \*\*\* Bank, datë \*\*\*.10.2019.

- Vendim i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 123, datë 10.9.2019, "Për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturës së z. B. Muçi, në vendet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese...".

- Shkresë e këshilltares së lartë znj. \*\*\*. \*\*\*. \*\*\* (ICITAP).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 12.11.2019

**Lënda:** Parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, datë 12.11.2019, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit z. Besnik Muçi

**Të nderuar anëtarë të trupit gjykues!**

Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësoi se vendimi nr. 58/2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nuk është në pajtueshmëri me provat e administruara, vuri në lëvizje juridiksionin kontrollues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Mbi bazën e shkaqeve të ankimit, kërkimeve dhe prapësimeve të palëve, si dhe vlerësimit tërësor të provave, shqyrtimi gjyqësor në Kolegj vijoi në respektim të dispozitave kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016 dhe, në çdo rast, subjektit të rivlerësimit iu garantua e drejta për një proces të rregullt ligjor, si dhe iu dha mundësia të provonte<sup>1</sup> të kundërtën për secilin shkak ankimi.

Komisioneri Publik çmon se hetimi dhe gjykimi i kësaj çështjeje provoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti që, me prova dhe argumente bindëse, të provojë të kundërtën e shkaqeve të ankimit. Si rrjedhojë, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e mosdeklarimit saktësisht dhe plotësisht të pasurisë, si dhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, referuar nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Ky përfundim gjen mbështetje në këto rrethana faktike e juridike, si vijon:

**1. Për pasurinë 1, apartament banimi me sip. 57 m<sup>2</sup>, i blerë në janar të vitit 2006, për vlerën 1.9 milionë lekë**

1.1 *Në deklaratën “Vetting”*, burimi i krijimit të kësaj pasurie deklarohet: (i) Kursime personale në shumën 200.000 lekë; (ii) Hua 500.000 lekë nga babai, që vijnë nga të ardhura personale dhe kursime të vëllait \*\*\*, \*\*\*, nga emigracioni; (iii) Hua 6.000 euro, nga motra \*\*\*, \*\*\*, dhe bashkëshorti i saj \*\*\*, \*\*\*, që vijnë si të ardhura nga emigracioni në Mbretërinë e Bashkuar; (iv) Hua 3.000 euro nga xhaxhi \*\*\*, \*\*\*, krijuar me të ardhura nga emigracioni.

<sup>1</sup> Sipas nenit Ç, pika 5 e aneksit të Kushtetutës, “Barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal”.

- 1.2 Në DV-2006, si burim krijimi për këtë pasuri deklarohen vetëm huat nga babai dhe xhaxhai, respektivisht në shumat 500.000 lekë dhe 3.000 euro, si dhe nga motra dhe bashkëshorti i saj, në shumën 6.000 euro.
- 1.3 Nga krahasimi i deklaratës periodike të vitit 2006 me atë “Vetting” 2017, rezulton se ka pasaktësi lidhur me deklarimin e burimit të krijimit të pasurisë, pasi në DV-2006 nuk deklarohet si burim, përdorimi i kursimeve të subjektit në shumën 200.000 lekë dhe as pakësimi i tyre.
- 1.4 Gjatë shqyrtimit gjyqësor, për burimin e krijimit të kësaj pasurie, Komisioneri Publik analizoi dhe mbajti qëndrimin se:
- 1.5 (i) Për kursimet personale në vlerën 200.000 lekë, përfundimi i Komisionit mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e këtyre kursimeve deri në vitin 2005 është i gabuar, pasi nuk gjen mbështetje në dokumentet provuese, referuar përcaktimeve të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Ndërkohë, shpjegimet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ të Komisionit lidhur me ndjekjen e një regjimi të rreptë ushqimor, si dhe ndihmat materiale të dhëna gjatë kësaj periudhe nga vjehri dhe vëllai i tij i konsideruam jo bindëse dhe në nivel deklarativ. Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, vetëm në seancën e fundit të datës 7.11.2019, subjekti i rivlerësimit, për herë të parë, ka ngritur pretendime për analizë të gabuar financiare të Komisionit, lidhur me nivelin e shpenzimeve jetësore, duke referuar në këtë rast dhe metodologjinë e ndjekur nga INSTAT-i.
- 1.5.1 Ky prapësim i subjektit, i cili nuk është bërë prezent gjatë hetimit administrativ të Komisionit, shtrihet edhe për vitet e tjera, në të cilat subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme për të mbuluar shpenzimet dhe kursimet e deklaruara, trajtuar më gjerësisht në vijim (pika 5).
- 1.6 (ii) Për huan e marrë nga babai, z. \*\*\*, \*\*\*, në shumën 500.000 lekë, rezulton se deklarimi i kësaj marrëdhënie huaje nuk shoqërohet dhe provohet me dokumentacion justifikues ligjor, referuar udhëzimit nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2016, të ILDKPKI-së, dalë në zbatim të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Si burim krijimi i kësaj shume, subjekti ka deklaruar të ardhura personale të babait dhe kursime të vëllait, \*\*\*, \*\*\*, nga emigracioni në Greqi.
- 1.6.1 Gjatë shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit paraqiti dhe u administruan në cilësinë e provës disa akte të reja, për të cilat vlerësuam se ato provojnë faktin e vetëpunësimit në bujqësi të prindërve të subjektit, por jo të ardhurat e realizuara dhe nëse ato plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin D, pika 3, e aneksit të Kushtetutës. Shpjegimi që subjekti bën, për të llogaritur të ardhurat e realizuara nga prindërit, bazuar në pagën minimale për të cilën janë paguar detyrimet ndaj sigurimeve shoqërore, të cilat më pas subjekti kërkon të llogariten në të ardhurat e ligjshme të prindërve, nuk gjen asnjë mbështetje ligjore.
- 1.6.2 Gjatë shqyrtimit gjyqësor, subjekti ka depozituar gjithashtu dhe një vërtetim për bazën e vlerësuar mbi të ardhurat e siguruara nga punësimi i së motrës, znj. \*\*\*, \*\*\*, në shumën totale rreth 565.000 lekë, për periudhën 2002-2005, e lëshuar nga Komuna Çërravë, periudhë në të cilën, sipas pretendimeve të subjektit, këto të ardhura kanë shërbyer në krijimin e kursimeve të deklaruara nga familja e babait të tij. Rezulton se ky burim të ardhurash nuk është deklaruar asnjëherë në deklaratat periodike, atë “Vetting” apo gjatë hetimit administrativ të Komisionit. Rrjedhimisht, ky burim nuk mund të përdoret në vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për huan e deklaruar të marrë nga babai.
- 1.6.3 Për të ardhurat nga emigracioni i vëllait, rezulton se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion, prova bindëse për të kundërtën e shkakut të ankimit. Aktet e

administruara mund të referojnë në qëndrimin e ligjshëm të të vëllait në shtetin grek, por në asnjë rast ato nuk provojnë punësimin dhe të ardhurat e ligjshme për efekt të procesit të rivlerësimit<sup>2</sup>. Në seancën e datës 20.9.2019, në të ardhurat e të vëllait, subjekti ka pretenduar për të përfshirë edhe të ardhurat nga biznesi “furrë buke”, në pronësi të vëllait, duke paraqitur disa dokumente mbi regjistrimin e këtij aktiviteti, kontrata të lidhura me Komisionarin e Policisë, Pogradec dhe lëvizjet e llogarisë bankare të këtij biznesi. Rezulton se ky burim të ardhurash nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti në deklaratat periodike dhe në atë “Vetting”, sikurse dhe gjatë hetimit administrativ të Komisionit. Rrjedhimisht, ky burim nuk mund të përdoret në vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të ardhurat e deklaruara nga emigracioni i të vëllait.

1.6.4 Mbajmë në konsideratë se objekti i kontrollit në këtë proces është edhe verifikimi i vërtetësisë së deklaratimeve të subjektit, sipas nenit D, pika 1, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-32 të ligjit nr. 84/2016, për pasojë mosdeklarimi saktësisht i burimeve që shërbejnë për krijimin e të ardhurave dhe të burimeve të krijimit të pasurive, nuk mund t’i shërbejnë më pas objektit të verifikimit për qëllim të procesit të rivlerësimit.

1.7 (iii) Për huan e marrë nga xhaxhai, z. \*\*\*. \*\*\*, në shumën 3.000 euro. Sipas deklaratimeve të subjektit, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, të ardhurat që kanë shërbyer si burim i kësaj huaje janë siguruar nga puna në bujqësi e xhaxhait dhe kursime nga emigracioni në Greqi. Rezulton se kjo marrëdhënie huaje nuk shoqërohet dhe provohet me dokumentacion justifikues ligjor.

1.7.1 Për sa i përket burimit të deklaruar, kursime nga emigracioni, subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë të re.

1.7.2 Për sa i përket të ardhurave nga puna në bujqësi e xhaxhait, subjekti referon të njëjtën bazë ligjore sikurse në rastin e huas së marrë nga babai i tij, pretendime këto të cilat nuk gjejnë mbështetje ligjore.

1.7.3 Në vijim të nevojës për të provuar burimin e ligjshëm të huas, për të ardhurat e familjes së xhaxhait, subjekti ka paraqitur dhe vërtetimin me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2019, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Korçë, sipas të cilit shtetasi \*\*\*. \*\*\*, për periudhën 1991- janar 2006 (kohë në të cilën është deklaruar huaja), ka realizuar të ardhura nga pensioni i pleqërisë, në shumën 1.133.227 (një milion e njëqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e njëzet e shtatë) lekë. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, këto të ardhura nuk mund të konsiderohen të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet vetjake familjare dhe huan e dhënë subjektit të rivlerësimit.

1.7.4 Për sa më sipër, Komisioneri Publik, bazuar në nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se nuk provohet me dokumentacion ligjor bindës, mundësia financiare e xhaxhait të subjektit të rivlerësimit për t’i dhënë hua këtij të fundit shumën 3.000 euro.

1.8 (iv) Për huan e marrë nga motra, znj. \*\*\*. \*\*\*, dhe bashkëshorti i saj, z. \*\*\*. \*\*\*, në shumën 6.000 euro, nga provat e paraqitura në seancën e datës 21.9.2019, lidhur me të ardhurat e krijuara nga huadhënësit në Mbretërinë e Bashkuar, Komisioneri Publik krijoi bindjen se kjo shumë mbulohet me burime të ligjshme, referuar nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.

1.9 Duke përfunduar për pasurinë 1, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion bindës, burimin e ligjshëm të kursimeve personale, si dhe burimin e ligjshëm të huave të deklaruara si të marra nga personat e tjerë të lidhur, babai dhe xhaxhai i tij, duke rezultuar kështu në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, sipas nenit 33, germa “b”, lidhur me nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

<sup>2</sup> Në këtë drejtim, referohuni edhe në praktikën e Kolegjit, si p.sh.: Vendimi (JR) nr. 15/2019.



## **2. Pasuria 2, apartament banimi me sip. 78.4 m<sup>2</sup>, i blerë në maj të vitit 2016, për vlerën 75.000 euro**

2.1 Në deklaratën “Vetting”, burimi i krijimit të kësaj pasuri deklarohet: (i) Kursime nga të ardhurat prej punës së deklaruesit dhe të bashkëshortes, në shumën 25.000 euro; (ii) Hua në shumën 15.000 euro, nga \*\*\*. \*\*\*, dhe \*\*\*. \*\*\*, përkatësisht, kunati i subjektit me bashkëshorten e tij, shtetase turke. Burimi i huas deklarohet nga kursimet e huadhënësve prej punës në kompaninë “\*\*\*\*” dhe menaxhimi i dy dyqaneve, shitje me shumicë dhe pakicë, mobilieri, ndodhur në Turqi. Shuma e huas është transferuar në Bankën \*\*\* (\*\*\*) në datën \*\*\*.5.2016; dhe (iii) Kredi bankare pranë \*\*\* Bank, në shumën 1.5 milionë lekë, datë \*\*\*.12.2016.

2.2 Si shkak ankimi, për një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie, huan e deklaruar në shumën 15.000 euro, Komisioneri Publik analizoi dhe mbajti qëndrimin se aktet e administruara gjatë hetimit administrativ të Komisionit nuk mjaftojnë për të krijuar bindjen mbi burimin e ligjshëm të huas. Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit prej Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Turqi, merret me rezervë për vlerën provuese të tij, pasi në aspektin formal ky dokumentacion nuk ishte i legalizuar, si dhe nuk vërtetonte se sa janë të ardhurat e realizuara nga personat e tjerë të lidhur për periudhën deri në maj të vitit 2016.

2.3 Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti depozitoi dokumentacion e nevojshëm ligjor të lëshuar nga autoritetet turke (mbi pagesën e sigurimeve shoqërore mbi të ardhurat), si dhe borderotë (provë e re) nga shoqëria “\*\*\*\*”, përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. Të ardhurat e pasqyruara në borderotë e shoqërisë përputhen me të ardhurat e deklaruara dhe të konfirmuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Turqi.

2.4 Subjekti, në parashtrimet e seancës së datës 21.9.2019, ka analizuar aftësinë financiare të personave të tjerë të lidhur për të mbuluar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua. Për të llogaritur shpenzimet minimale të jetesës së personave të tjerë të lidhur, subjekti ka referuar të dhënat e faqes zyrtare që mat nivelin e shpenzimeve minimale në Turqi, duke marrë në konsideratë nivelin më të ulët të shpenzimeve të matshme, në të cilin përfshihen vetëm shpenzimet mujore për ushqim, për një familje me katër persona.

2.5 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, të dhënat e referuara nga subjekti mbi limitin minimal të shpenzimeve janë në nivele tepër të ulëta, për t’u konsideruar në analizën financiare të personave të tjerë të lidhur<sup>3</sup>. Në rastin më të mirë, nisur nga fakti se subjekti ka provuar me dokumentacion se personat e tjerë të lidhur jetojnë në shtëpinë e të afërmeve, pa pagesë, vlerësojmë se shpenzimet e jetesës duhet të llogariten si një mesatare e thjeshtë aritmetike e dy niveleve të përcaktuara mbi shpenzimet e jetesës në shtetin turk<sup>4</sup>.

2.6 Duke analizuar të dhënat si më sipër, nisur dhe nga fakti që shuma e huas së dhënë subjektit është sa rreth 45% e totalit të të ardhurave neto nga pagat e personave të tjerë të lidhur, për periudhën 2013-2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk arrin të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

## **3. Për transaksionet e evidentuara si të kryera nga subjekti i rivlerësimit në llogarinë e së motrës, pranë \*\*\* Bank**

3.1 Për këtë shkak ankimi, gjatë shqyrtimit gjyqësor, subjekti ka deklaruar se burimi i transaksioneve ka qenë nga të ardhurat nga emigracioni i kunatit të tij, \*\*\*. \*\*\*, me qëllim depozitimin e shumës së nevojshme për garanci në llogarinë bankare të së motrës, për efekt të

<sup>3</sup> Subjekti referon si nivel shpenzimesh nivelin më të ulët, që parashikon vetëm nevojat bazike për ushqim të një familjeje në Turqi, pa përfshirë shpenzimet për qira, veshmbathje, energji, ujë, gaz etj.

<sup>4</sup> Mesatarja e treguesve “limit of hunger” dhe “limit of poverty” sipas burimit: <http://www.turkis.org.tr/LIMIT-OF-HUNGER-AND-POVERTY>, meqenëse subjekti ka provuar se personat e tjerë të lidhur nuk paguajnë shpenzime qiraje.

marrjes së vizës së qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar. Transaksionet janë kryer nga subjekti, pasi dispononte prokurë për të vepruar.

3.2 Komisioneri Publik, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë marrëdhënie në formularët e deklarimit pranë ILDKPKI-së, si dhe nuk provohet me asnjë dokument apo rrethanë mënyra e kalimit të këtyre likuiditeteve nga Mbretëria e Bashkuar për në Shqipëri, vlerëson se pretendimet e subjektit për këtë shkak ankimi nuk janë bindëse.

#### **4. Për mosdeklarimin e pasurisë**

4.1 Komisioneri Publik mbajti qëndrimin se prapësimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk gjejnë asnjë mbështetje ligjore për të rrëzuar këtë shkak ankimi. Referenca në ligjin nr. 8337/1998 dhe në udhëzimin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nuk marrin vlerë në gjykimin e këtij shkak.

4.2 Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë rrethanë ligjore bindëse mbi arsyet që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, të mos deklaroni saktësisht dhe mjaftueshmërisht pasuritë e tyre në pronësi dhe bashkëpronësi apo të drejtat mbi to, si detyrim ligjor i parashikuar qartë në nenin D, pikat 1, 2 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, nenin 32, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, pika 7 e udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, si dhe në formularin e deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit 2017.

#### **5. Mosmbulimi i shpenzimeve vjetore nga të ardhura me burime të ligjshme**

5.1 Nga analiza financiare e të ardhurave dhe të shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, Komisioneri Publik në ankim ka mbajtur qëndrimin se, sikurse ka rezultuar edhe gjatë hetimit administrativ të Komisionit, subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës, shpenzimet vjetore për vitet 2003 dhe 2004 (si dhe kursimet e deklaruara në vitit 2005, analizuar mbi burimet e krijimit të pasurisë 1).

5.2 Në parashtrimet e tij, të datës 3.9.2019<sup>5</sup>, subjekti ka deklaruar se, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni mbi diferencat e konstatuara ndër vite, ai (subjekti) ka paraqitur të dhëna, prova dhe argumente shtesë lidhur me këto fakte. Subjekti në këto parashtrime ka argumentuar se shpenzimet familjare për këto vite kanë qenë të kufizuara dhe ka vlerësuar si të drejtë paraqitjen dhe analizën e fakteve, dhe konkluzionet e arritura nga Komisioni, duke konkluduar se ky i fundit ka vendosur bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, parashikuar në nenet 4/5 dhe 52/1 të ligjit nr. 84.2016, duke pranuar kështu diferencat negative të konstatuara ndër vite.

5.3 Ndërkohë, në parashtrimet e tij, në seancën e datës 7.11.2019, subjekti ka prapësuar analizën dhe të dhënat e përdorura nga Komisioneri Publik mbi shpenzimet e jetesës për këto vite, të dhëna të cilat janë të njëjta me ato të llogaritura nga Komisioni, duke pretenduar nivele më të ulëta të shpenzimeve të jetesës, si dhe përfshirjen në këto shpenzime edhe të zërave të tjerë, si qira banese dhe blerje mobiliesh. Rezulton se këto pretendime janë ngritur vetëm në seancën gjyqësore të datës 7.11.2019, ndërkohë që me këta zëra dhe mënyrë llogaritjeje, subjekti është njohur që prej hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, e të cilat nuk i ka kontestuar.

5.4 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se shpjegimet e subjektit të paraqitura në seancën gjyqësore të datës 7.11.2019 janë kontradiktore me shpjegimet e dhëna gjatë seancës së datës 3.9.2019, si dhe me shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, të kryer nga Komisioni.

---

<sup>5</sup> Referohuni faqes 18 të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në seancën e datës 3.9.2019.

## **6. Për informacionin e përcjellë nga ana e DSIK-së**

Me vendimin e ndërmjetëm në seancën gjyqësore të datës 1.10.2019, Kolegji vendosi të administrojë si provë dhe t'ia nënshtrojë debatit gjyqësor të palëve, informacionin e përcjellë nga ana e DSIK-së. Lidhur me këtë fakt, Komisioneri Publik i qëndron parashtrimeve të tij të datës 16.10.2019, pasi vlerëson se rrethanat dhe faktet e paraqitura në të, së bashku me provat dhe shpjegimet e subjektit, të administruara për këtë qëllim, në vështrim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, mund të shërbejnë në vlerësimin tërësor të çështjes.

## **Kërkimi përfundimtar i ankimit**

**7.** Në përfundim të këtyre parashtrimeve, Komisioneri Publik vlerëson se:

7.1 Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur dhe të tjerë të lidhur me të, nuk arrijnë të justifikojnë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe të pasurive të deklaruara, të krijuara në vitet 2006 dhe 2016, referuar nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016;

7.2 Për vitet 2003, 2004 dhe 2005, nga analiza financiare, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe kursimet e deklaruara;

7.3 Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mosdeklarimit të pasurisë dhe të deklarimit të pamjaftueshëm, referuar nenit D, pikat 1 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016;

7.4 Në interpretim të nenit D, pikat 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, nenit 33 dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë;

7.5 Bazuar në nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenin 66, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë, nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 58, datë 1.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Muçi.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Darjel SINA**